

ALBCHROME sh.p.k.

Pasqyrat Financiare së bashku
me Raportin e Audituesit të Pavarur
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	(i)
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE.....	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	5
2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL	5
3. TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTËT	23
4. TË ARDHURA TË TJERA	23
5. BLERJA E MATERIALEVE.....	24
6. SHPENZIME PERSONELI	24
7. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE.....	25
8. AMORTIZIMI DHE ZHVLERËSIMI.....	26
9. FITIMI /(HUMBJA) NETO NGA KURSI I KËMBIMIT.....	26
10. SHPENZIMET PËR INTERESAT SHPENZIMET.....	26
11. TATIMI MBI FITIMIN.....	26
12. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE.....	28
13. AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE.....	29
14. AKTIVET MINERARE TË SHTYRA	30
15. QIRATË.....	31
16. INVENTARI.....	31
17. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE	32
18. TË TJERA LLOGARI TË ARKËTUESHME DHE PARAPAGIME	33
19. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE TË TYRE.....	33
20. KAPITALI AKSIONAR	33
21. HUAMARRJET	34
22. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE.....	34
23. DETYRIME TË TJERA.....	34
24. DETYRIME PËR PËRFITIMET E PUNONJËSVE	34
25. PROVIZIONE.....	35
26. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA	35
27. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT	36
28. VLERA E DREJTË.....	39
29. ADMINISTRIMI I KAPITALIT.....	39
30. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA.....	40
31. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT	40



Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
MBRS: K519116121
Rr. Ibrahim Rugova,
Sky Tower, 8th floor
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419076
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Drejtimin e Albchrome sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Albchrome sh.p.k ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2020, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 " Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi dhe personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjyklimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Albchrome sh.p.k., përvec të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për informacione të tjera të Përfshira në Raportin e Drejtimit 2020 të Albchrome sh.p.k.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin e Drejtimit të Shoqërisë për vitin 2020, përgatitur në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 21 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përvec pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti i Drejtimit të Shoqërisë për vitin 2020 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale.

Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Ekspertë Kontabël të Autorizuar
24 June 2021

Tiranë, Shqipëri



Alba Pine
Auditues Ligjor

Alba Pine


Albchrome sh.p.k.*(Vlerat janë të shprehura në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2020

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga kontratat me klientët	3	4.490.208	7.523.832
Të ardhura të tjera	4	48.679	93.182
Të ardhurat		4.538.887	7.617.014
Ndryshimet e gjendjes së inventarit		148.262	(1.074.675)
Blerja e materialeve	5	(2.330.273)	(4.748.522)
Shpenzime për personelin	6	(1.253.163)	(1.356.868)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	7	(401.374)	(526.686)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	8	(640.084)	(551.662)
Fitimi/(Humbja) neto nga kursi i këmbimit	9	113.469	(24.190)
Fitimi/(Humbja) operativ		175.724	(665.589)
Të ardhurat nga interesat		7	168
Shpenzimet për interesat	10	(146.769)	(121.364)
Fitimi/(Humbja) para tatimit		28.962	(786.785)
Tatimi mbi fitimin	11	(23.716)	123.759
Fitimi/(Humbja) për vitin financiar		5.246	(663.027)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse për vitin		5.246	(663.027)

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e vendosura në faqet 5 deri 40 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Albchrome sh.p.k.*(Vlerat janë të shprehura në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**
Më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktivët afatgjatë			
Aktivët afatgjatë materiale	12	3.602.381	3.842.574
Aktivët afatgjatë jomateriale	13	183.341	182.932
Aktive minerare të shtyra	14	3.269.946	3.120.284
Aktive me të drejtë përdorimi	15	91.253	64.147
Aktive tatimore të shtyra	11	194.826	218.542
		7.341.747	7.428.479
Aktivët afatshkurtra			
Inventari	16	1.944.180	1.963.156
Llogari të arkëtueshme tregtare	17	878.388	296.724
Të tjera llogari të arkëtueshme dhe parapagime	18	747.228	925.883
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	19	9.563	49.800
		3.579.349	3.235.563
TOTALI I AKTIVEVE		10.921.096	10.664.042
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali aksionar	20	3.765.963	3.765.963
Fitimi i akumuluar		2.412.946	2.437.949
		6.178.909	6.203.912
Detyrimet afatgjatë			
Huamarrjet afatgjatë	21	339.603	1.322.512
Detyrimet e qirasë afatgjatë	15	63.804	37.574
Detyrime për përfitimet e punonjësve	24	34.844	-
		498.251	1.360.086
Detyrimet afatshkurtra			
Huamarrjet afatshkurtra	21	2.371.382	1.555.439
Huamarrje nga palët e lidhura	21	283.980	166.239
Detyrimet e qirasë afatshkurtrë	15	27.360	26.013
Llogaritë e pagueshme tregtare	22	632.350	508.917
Detyrime të tjera	23	544.370	367.821
Provizione	24	78.470	68.168
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	25	306.024	407.447
		4.243.936	3.100.044
TOTALI I DETYRIMEVE		4.742.187	4.460.130
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		10.921.096	10.664.042

Pasqyrat Financiare në faqet 1 deri 4 janë firmosur dhe aprovuar më 24 June 2021 nga:Luan Saliaj
Drejtor EkzekutivElisabeta Hajrullai
Drejtor Financie

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e vendosura në faqet 5 deri 40 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Albchrome sh.p.k.*(Vlerat janë të shprehura në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2020

	Kapitali Aksionar	Fitim i Akumuluar	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	3.765.963	3.100.976	6.866.939
Humbja neto e vitit	-	(663.027)	(663.027)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	(663.027)	(663.027)
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	3.765.963	2.437.949	6.203.912
Lëvizje të tjera	-	(30.249)	(30.249)
Fitimi neto i vitit	-	5.246	5.246
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	5.246	5.246
Gjendja më 31 dhjetor 2020	3.765.963	2.412.946	6.178.909

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e vendosura në faqet 5 deri 40 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Albchrome sh.p.k.*(Vlerat janë të shprehura në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE****Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2020**

	Shënime	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti operativ			
Fitimi/(Humbe) para tatimit		28.962	(768.786)
<i>Regullimet për zërat jo-monetare:</i>			
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	12/13/14	634.628	553.812
Amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	15	23.998	24.314
Provizjone/(rimarrje)	24/25	67.579	(13.481)
Provizjone për përfitimet e punonjësve		4.695	-
Provizjone për rehabilitimin		9.220	-
Fajlre e llogarive të arkëtueshme		-	4.824
Të ardhura nga interesat	10	(7)	(168)
Shpenzime për interesat	10	148.789	121.364
Humbljet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale		(367)	-
Provizjone për llogarilë e pagueshme tregtare		(13.815)	-
Regullime të tjera nga vili paraardhës		(30.249)	-
		871.313	(96.101)
Rregullimi për zërat e kapitalit qarkullues:			
(Rritje)/zvogëlim në inventar	15	810	1.148.428
(Rritje)/zvogëlim në llogari të arkëtueshme	17	(681.665)	587.131
Rritje në llogari të tjera të arkëtueshme	18	183.808	243.568
(Zvogëlimi)/ritje në llogari dhe të tjera të pagueshme tregtare	22/23	292.388	(1.043.624)
Rritje në llogari të pagueshme ndaj palëve të treta		(101.423)	(512.449)
		(226.072)	403.063
Interesi i paguar		(145.072)	(118.759)
Tallim fillimi i paguar		-	(82.265)
Mjete monetare neto nga aktiviteti operativ		500.169	104.928
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i investimit			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	12	(208.828)	(402.678)
Zhvillim i aktiveve minierare	14	(322.836)	(458.149)
Aktive me të drejtë përdorimi	15	(51.104)	-
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	12	3.701	888
Mjete monetare neto përdorur nga aktiviteti i investimit		(577.067)	(859.929)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i financimit			
Rritje në huatë afatgjata	21	431.827	166.238
Pagesë e huave afatgjata	21	(361.782)	(357.457)
Rritje e overdratëve bankare	21	(50.070)	986.422
Pagesa kryesore për detyrimet e qirasë	16	27.578	(26.311)
Interesi i paguar për detyrimet e qirasë		(1.690)	-
Mjete monetare gjeneruar/(përdorur) në aktivitetin e financimit		36.863	778.893
Rritje/(rënia) neto në mjetet monetare dhe ekivalente të tyre		(40.237)	23.892
Mjete monetare dhe ekivalente të tyre më 1 janar		49.800	25.908
Mjete monetare dhe ekivalente të tyre më 31 dhjetor	18	9.663	49.800

Pasqyra e flukst të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet e vendosura në faqet 5 deri 40 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Albchrome sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Albchrome sh.p.k. ("Shoqëria") është themeluar më 4 prill 2000, me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës nr. 23.729.

Në 2007, Shoqëria ndryshoi emrin e saj nga Darfo Albania Sh.p.k në Albanian Chrome Sh.p.k. Ndryshimi i emrit erdhi si pasojë e ndryshimit në pronësi nga Darfo në Itali, e cila u ble nga DCM Deco-metal dhe Terwingo. Rrjedhimisht, gjatë 2010 Shoqëria ndryshoi emrin nga Darfo SRL në ACR Holding SRL dhe është një degë në pronësi të plotë të DCM Deco-metal në Austri. Më 25 shkurt 2013 ACR Holding SRL-Itali u ble plotësisht nga Balfin sh.p.k dhe si rrjedhojë shoqëria kontrolluese ka ndryshuar. Kontrolli perfundimtar i Shoqërisë mbahet nga Balfin sh.p.k.

Zyra e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në Rrugën Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, kati i 1-rë, nr.3 Tiranë. Shoqëria më 31 Dhjetor 2020 ka pasur 1.053 punonjës (31 dhjetor 2019: 1.029 punonjës).

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 17 datë 16.01.2019, në zbatim të ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009, një njësi ekonomike mund të klasifikohet e rëndësishme si Njësi me Interes Publik (NIP) për shkak të natyrës së biznesit, madhësinë ose numrin e punonjësve të tyre. Bazuar në pikën IV të këtij vendimi, Albchrome shpk klasifikohet si NIP si rezultat i plotësimit të kriterëve.

1.1 Marrëveshja Konçensionare

Më nënshkrimin e marrëveshjes konçensionare, Shoqëria ka marrë më 1 qershor 2000 një konçesion të tipit **BOT (Ndërto-Opero-Transfero)** për objektet e mëposhtme për 30 vjet: një fabrikë Ferro-kromi në Elbasan dhe dy miniera kromi në Përrenjas dhe Pojsk, për shumën prej Leke 168.000 mijë. Në datë 25.07.2016, ligji Nr 79/2016, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi shtyerjen e periudhës së konçesionit deri më 31 dhjetor 2040.

Shoqëria më 22 qershor 2001 mori një konçesion të tipit **ROT (Rehabilito-Opero-Transfero)** për objektet e mëposhtme për 30 vjet. Një minierë kromi në Bulqizë, një fabrikë mineraleve në Bulqizë, një fabrikë për përzgjedhjen e mineraleve në Klos dhe një fabrikë ferro-kromi në Burrel për një shumë prej Leke 248.000 mijë. Në datën 25 korrik 2016, ligji nr 79/2016, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi shtyerjen e periudhës së konçesionit deri më 31 dhjetor 2040.

Bazuar në marrëveshjet konçensionare Shoqëria duhet të përmbush një sërë kriteresh specifike të investimeve për të dy marrëveshjet konçensionare. Gjatë kësaj periudhe, janë realizuar investime sipas planit të parashikuar në marrëveshjen e konçesionit, vlerë të konsiderueshme zënë investimi për furrën e re në Burrel, projekti i Traverbankut Klos-Bulqizë, projekti i zhvillimit të thellësisë së Pusit 9 në Bulqizë dhe është në proces investimi në projektin e thellësisë në minierën e Qaf Buallit. Vlera totale e investimeve të planifikuara në marrëveshjen konçensionare të tipit ROT është përlogaritur në shumën totale prej 34.8 milion USD për të gjithë periudhën e dhënies me koncesion, ndërkohë në marrëveshjen konçensionare të tipit BOT investimet e parashikuara janë përlogaritur në shumën 1.01 milion Euro.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

a. Politikat Kontabël

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

b. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike. Monedha e përdorur për paraqitje është Leku Shqiptar (Lekë) që është gjithashtu edhe monedha funksionale dhe të gjitha vlerat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt ('000 Lekë), përveç kur përcaktohet ndryshe.

Shoqëria i mban të dhënat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare në pajtueshmëri me Ligjin mbi Kontabilitetin nr. 25/2018 datë 10 maj 2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2019. Shoqëria pasi ka përmbushur kushtet përkatëse ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të SNRF (Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar) të cilat u bënë të detyrueshme në Shqipëri me anë të Urdhrit të Ministrisë së Financave nr. 65, datë 25 maj 2008 "Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe".

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

Parimi i vijueshmërisë

COVID-19 dhe masat përkatëse për të ngadalësuar përhapjen e virusit kanë patur një ndikim të rëndësishëm në ekonominë shqiptare dhe globale, shitjet, furnizimet dhe tregjet financiare, kanë rezultuar në rritje të niveleve të paqëndrueshmërisë dhe pasigurive. Efektet e kësaj krize shëndetësore po vazhdojnë të shpalosen dhe shkalla përfundimtare e ndikimit ekonomik në të gjithë botën janë të panjohura.

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, COVID-19 ka ndikuar në Shoqëri, konkretisht si më poshtë:

- Klientët kanë shtyrë dërgesat e rregullta mujore për periudhën e mëvonshme.
- Viti 2020 ishte një vazhdim i përkeqësimit të tregut pas një viti shumë të vështirë që kaloi industria në 2019, ku për shkak të kërkesës së ulët, çmimet e FeCr u ulën me rreth 35%, duke arritur nivelin më të ulët në 10 vitet e fundit.
- Me shpërthimin e pandemisë fillimisht në Kinë dhe më pas në Europë dhe në vendet e tjera të botës si edhe masat kufizuese që ndërmorën vendet, ndikuan ndjeshëm në kërkesën dhe furnizimin e FeCr.
- Tregu i SPOT në Evropë dhe SHBA pësoi disa ndërprerje edhe në Përbushjen e Marrëveshjes Afatgjatë.
- Aktiviteti prodhues u zhvillua normalisht edhe pas shpërthimit të pandemisë. Shoqëria ka vazhduar operimin me 2 furra (50% të kapacitetit të prodhimit) në vitin 2020, që nga qershori i 2019.
- Gjatë vitit 2020 Shoqëria u mbështet financiarisht nga aksionarët, në financimin operacional, i cili planifikohet të shlyhet plotësisht nga aktiviteti operativ i fluksit të parave gjatë vitit 2021.

Në këtë situatë masat e marra nga Shoqëria pas shpërthimit të pandemisë ishin:

1. Shoqëria edhe në vitin 2020 vazhdon të operojë me 50% të aktivitetit të prodhimit pasi ka patur një kërkesë në nivel të për Ferrokrom në tregun ndërkombëtar.
2. Bazuar në një vendim të Bankës së Shqipërisë, Shoqëria aplikoi për shtyrjen e pagesave për tre huadhënësit kryesorë (bankat e nivelit të dytë) në Shqipëri për 2 këste kredie, Mars dhe Qershor 2020. Duke filluar nga Shtatori 2020 Shoqëria po kryen ripagimin e huave afatgjata sipas planit të amortizimit të kontraktuar.
3. Qeveria e Shqipërisë në bashkëpunim me bankat e nivelit të dytë injektoi një fond për të ndihmuar bizneset në pagimin e pagave të personelit. Shoqëria aplikoi për këtë fond të injektuar dhe huazoi rreth \$ 1.9 milion.
4. Investimi në CAPEX u rishikuan dhe u shtynë pas shpërthimit të pandemisë duke u përqëndruar në objektiva të tjera më të rëndësishme.
5. Meqenëse u tregua një kërkesë e dobët në tregun evropian, Shoqëria rriti eksportin në tregun e Kinës, duke shitur në çmim-kosto për të mbështetur nevojat e fluksit të parave.

Më 31 Janari 2021, Drejtimi i Shoqërisë ka përgatitur pasqyrën e parashikuar financiare për dymbëdhjetë muaj nga data e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, duke marrë parasysh vlerësimin e ndikimeve të vazhdueshme të biznesit nga COVID-19. Komponenti kryesor i cili ndikoi në vendimin për procesin në vazhdim janë çmimet e shitjes.

Në fund të vitit 2020 dhe në fillim të vitit aktual, çmimi i shitjes së Ferrokromit filloi të rritet, mbyllja e furrave me një kapacitet prej më pak se 25,000 MWA në Mongoli dhe Kinë, shkaktoi një rritje të kërkesës dhe çmimeve për periudhë kohore të shkurtër. Kjo ngjarje ka krijuar një moment pozitiv në treg i cili është përhapur shpejt në të gjithë globin, kështu që çmimet në Europë dhe SHBA ndoqën trendin e çmimeve në Kinë. Lulahje të forta të çmimeve u vunë re në gjysmën e parë të vitit dhe trend pozitiv për pjesën tjetër të vitit pas korrikut. Vlerësohet se çmimi për 2021 do të vazhdojë të jetë më i fortë se në dy vitet e fundit.

Në këtë periudhë AlbChrome ishte përqëndruar në përmirësimin e kostove operacionale, ku e filloi vitin me 1,233 \$ / mt në janar 2020 në 1,044 \$ / mt në dhjetor 2020 duke ulur kostot e prodhimit / njësi.

Bazuar në këto parashikime dhe mundësinë aktuale të tregut, si edhe duke marrë parasysh anët e dobëta të mundshme, Shoqëria filloi të operojë me kapacitet të plotë nga mesi i marsit 2021 dhe parashikon të vazhdojë po njësoj në muajt në vazhdim.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**Parimi i vijueshmërisë (vazhdim)**

Drejtimi mbetet i përqendruar në likuiditetin e Shoqërisë dhe pret që të menaxhojë operacionet e biznesit në periudhën e parashikimit duke mbajtur nën rishikim rreziqet e tregut.

Tabela si më poshtë paraqet të ardhurat e Shoqërisë sipas tremujorit në mijë lekë. Efekti negativ më i madh u shkaktua nga ulja e çmimit dhe sasisë së shitjeve.

Periudha	T1	T2	T3	T4
2019	2,520,084	2,467,229	1,452,431	1,084,089
2020	1,297,211	819,948	855,463	1,515,133

c. Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj fillimisht regjistrohen nga Shoqëria me kursin e këmbimit respektiv në datën që kryhet transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare në valutë të huaj rivlerësohen me kursin e këmbimit të monedhës funksionale në datën e raportimit. Të gjitha ndryshimet vendosen në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim të të gjitha njësive monetare që ofrojnë mbrojtje për një investim neto në një operacion të huaj. Këto njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në momentin e ç'registrimit të investimit neto, kohë në të cilin ato njihen në pasqyrën e të ardhurave. Shpenzimet dhe kompensimet fiskale të cilat i detyrohen ndryshimeve të kursit të këmbimit të njësive monetare gjithashtu regjistrohen tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Njësitë jo-monetare të cilat maten me kosto historike në valutë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datat e fillimit të transaksioneve. Njësitë jo-monetare të cilat maten me vlerën e drejtë në valutë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është përcaktuar. Humbja ose fitimi i krijuar nga ripërkthimi i njësive jo-monetare trajtohet në të njëjten mënyrë me njohjen e fitimeve ose humbjeve që rezultojnë nga ndryshimi në vlerën e drejtë të njësisë, (që do të thotë: diferencat e konvertimit të njësive, fitimet ose humbjet nga vlera e drejtë e të cilave njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose në fitim-humbjet njihen gjithashtu në të ardhura të tjera të tjera gjithëpërfshirëse ose fitim-humbje, respektivisht).

d. Të ardhurat nga kontratat me klientët

Shoqëria është e angazhuar në nxjerrjen e mineralit të kromit, si dhe në prodhimin dhe tregtimin e ferro-kromit. Shoqëria operon si njësi kryesore në kontratat e shitjes dhe tregtimit të ferro-kromit.

Bazuar dhe në SNRF 15, Shoqëria njih të ardhurat nga kontratat me klientët duke përdorur një model me pesë hapa për kontabilizimin e të ardhurave që rezultojnë nga kontratat me konsumatorët:

- identifikimi i kontratës me një klient;
- identifikimi i detyrimeve të performancës në kontratë;
- përcaktimi i çmimit të transaksionit;
- shpërndarja e çmimit të transaksionit ndaj detyrimeve të performancës në kontratë, dhe
- njohja e të ardhurave kur (ose si) njësi ekonomike përbush një detyrim të performancës;

Shoqëria është e përfshirë në aktivitetin e tregtimit të ferro-kromit në tregun ndërkombëtarë duke lidhur kontrata shitje ku u premtim klientëve shitjen e ferro-kromit (sipas kushteve të paracaktuara të cilësive dhe fraksioneve) sipas kontratave individuale.

Produkti i shitur është një tip dhe i vetëm ndaj mund të identifikohet në mënyrë individuale me një çmim individual për secilin grup cilësie apo fraksioni. Çmimi i shitjes mund të identifikohet lehtësisht në kontratat e shitjes bazuar në referencën e përdorur sipas kuotimeve të çmimeve në treg, si për kontratat afatgjata dhe ato spot. Sipas termave të kontratës çmimi referencë do të varet kuotimi në datën që blerësi do të kërkojë të tërheqë produktin.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

d. Të ardhurat nga kontratat me klientët (vazhdim)

Ndryshimet e çmimit: Shoqëria e përcakton çmimin e shitjes bazuar në termat e cilësisë, megjithatë ferrokromi është subjekt dhe i matjeve të cilësisë nga palë të treta të pavarura. Nëse produkti ka një përqindje cilësie të ndryshme ajo e parashikuar në kontratë çmimi për njësi është subjekt ndryshimi. Shoqëria ka instaluar instrumenta matës me besueshmëri të lartë dhe nuk pret ndryshime të çmimit që mund të ndryshojnë në mënyrë materiale të ardhurat e njohura. Megjithatë, në rastet kur këto verifikohen, Shoqëria pakëson të ardhurat për zbritjet e rëna dakord.

Njësia ekonomike i njeh të ardhurat kur plotësohet kushti i performancës atëherë kur produkti konsiderohet i transferuar nëse klienti e kontrollon atë. Kontrolli i një aktivi i referohet aftësisë për ta përdorur drejtpërdrejt atë aktiv dhe mbajtur thelbësisht të gjitha përfitimet që rrjedhin nga ky aktiv. Kontrolli përfshinë aftësinë për të ndaluar njësitë e tjera nga përdorimi i tij dhe përvetësimi i përfitimeve nga ky aktiv. Të ardhurat do të njihen nga ana e Shoqërisë në atë masë që është e mundur që përfitimet ekonomike të rrjedhin drejt saj dhe të ardhurat të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur do të behet pagesa. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh kushtet e përcaktuara në kontratën e pagesës dhe duke përjashtuar taksat apo detyrimet. Shoqëria ka arritur në konkluzionin që të ardhurat nga shitja e ferro-kromit njihen kur rreziqet dhe përfitimet nga pronësia (p.sh. transferimi i kontrollit) i janë transferuar klientit, rimarrja e shumës është e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri.

Termet e pagesës sipas kushteve kontraktuale përcaktojnë që blerësi do të duhet të paguaj menjëherë duke filluar që nga momenti që Shoqëria dorëzon setin e dokumentave të përcaktuara në kontratë si: faturën tregtare, çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, fletëpeshat si dhe faturën e ngarkesës.

Të drejtat e arkëtueshme njihen në datën e shitjes, ndërkohë ekziston një hapësirë kohore prej 15-30 dite midis momentit të njohjes së të drejtave të arkëtueshme dhe arkëtimit për shkak të dorëzimit të gjithë setit të dokumentave nga shitësi tek blerësi duke përfshirë dhe faturën e ngarkesës.

Klasifikimi si Kryesor apo Agjent

Në zbatim të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit Shoqëria vlerëson nëse në kontratat me klientet, ajo luan rolin e Kryesorit apo Agjentit. Ky vlerësim bëhet në nivelin e kontratës apo grupit të kontratave të ngjashme. Bazuar në termat e kontratës, Shoqëria luan rolin e kryesorit në shitjen e ferro-kromit dhe rolin e agjentit në dhënie e shërbimeve të transportit në shitjen e ferro-kromit.

Shoqëria realizon një pjesë të shitjeve sipas kushteve të kontratës CFR (Cost and Freight) ose CIF (Cost Insurance and Freight), ku kalon kontrollin e produktit të shitur tek klienti në momentin e ngarkimit në anije (si principal) që përkon me datën në të cilën ka transferuar kontrollin tek klienti, por njëkohësisht angazhohet për të siguruar shërbimin e transportit (si agjent) në të cilën ka përmbushur detyrimet e transportit për klientin e cila përkon në një moment të caktuar kur transporti përfundon. Në këtë mënyrë Shoqëria ka një detyrim të performancës për shërbimin e transportit i cili ofrohet vetëm për të lehtësuar shitjen e produktit.

Kushtet e tjera të kontratës që përdoren më së shumti nga Shoqëria si FOB (Free on Board) nuk e ngarkojn atë me përgjegjësin për të ofruar shërbimin e transportit apo të sigurimit, pasi malli është ngarkuar në portin e nisjes, apo kushtet e kontratës DAP (Delivered at Place) ku kontrolli kalon pasi produktet janë dorëzuar në portin e mbërritjes. Për këto kushte të kontratës i vetmi detyrim i performancës është ofrimi i produktit në pikën ku do të transferohet kontrolli.

Çmimi i transaksionit për shitjet sipas kushteve të kontratës CIF ose CFR mund të ndahet midis momentit kur produkti do të ngarkohet në anije, pra kur kemi kalimin e kontrollit dhe pjesa e të ardhurave në lidhje me sigurimin e shërbimit të transportit mund të njihet në kohë kur shërbimet e transportit të kryhen. Të ardhurat që lidhen me sigurimin e shërbimit të transportit mund të nevojiten të paraqiten të ndara nga të ardhurat e produkteve (kur janë të trupëzuara), në pasqyrën e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ose në shënimet shpjeguese.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

d. Të ardhurat nga kontratat me klientët (vazhdim)

a) Aktiv i kontratës

Një aktiv i kontratës me klientet është e drejta për konsiderata në shkëmbim të produkteve apo shërbimeve të transferuar tek klientët. Nëse Shoqëria përmbush duke transferuar produkte apo shërbime tek një klient përpara se ai të paguaj apo përpara se pagesa të jetë e detyrueshme, një aktiv i kontratës njihet për konsiderata që do përfitohen dhe janë të kushtëzuara.

b) Të drejta të arkëtueshme

Një e drejtë arkëtueshme përfaqëson për Shoqërinë një të drejtë të pakushtëzuar (p.sh. vetëm kalimi i kohës kërkohet përpara se pagesat e shumës të jenë të detyrueshme).

c) Detyrim i kontratës

Një kontratë e detyrimeve është një detyrim për të transferuar produkte apo shërbime tek klienti për të cilat Shoqëria ka marrë një shumë financiare nga klienti. Nëse klienti paguan këtë shumë përpara transferimit të produkteve apo shërbimeve, një detyrim i kontratës do njihet kur pagesa është kryer ose e detyrueshme për tu kryer (cilado qoftë më përpara). Një detyrim i kontratës do të njihet si e ardhur kur Shoqëria përmbush apo realizon detyrimin e kontratës.

e. Taksa

Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi të ardhurat për periudhën aktuale matet me shumën që pritet të rimerret ose paguhet nga autoritetet tatimore. Normat dhe legjislacioni tatimor i përdorur për të llogaritur shumën e tatimit mbi fitimin janë ato që janë në fuqi ose që konsiderohen të tilla, në datën e raportimit në vendet ku Shoqëria operon dhe gjeneron të ardhura të tatueshme.

Tatimi aktual mbi të ardhurat lidhur me njësitë që njihen drejtpërdrejtë në kapitalin neto, njihet në kapital dhe jo në pasqyrën e të ardhurave. Drejtimi vlerëson periodikisht pozicionet e marra në deklaratat tatimore në lidhje me situatat në të cilat rregulloret e aplikueshme tatimore janë subjekt interpretimi dhe krijon provigjone aty ku është e përshtatshme.

Tatimi shtyrë

Tatimi i shtyrë llogaritet duke përdorur metodën e detyrimit bazuar në diferencat e përkohshme në datën e raportimit midis bazave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerës së mbetur për qëllime të raportimit financiar. Vlera kontabël e aktivit tatimor të shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është më e mundshme që fitimi i mjaftueshëm i tatueshëm të jetë në dispozicion për të lejuar tatimin e shtyrë të aktiveve të përdoret. Aktivet e panjohura tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë masë që është bërë e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të lejojë tatimin e shtyrë të aktiveve të rimerret.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra maten me normat tatimore që priten të zbatohen në vitin kur aktivitet do të përfitohet ose detyrimi shlyhet, bazuar në normat e tatimeve (dhe ligjet tatimore) të cilat janë në fuqi ose kanë hyrë në mënyrë thelbësore në fuqi në datën e raportimit (p.sh. 15%). Tatimi i shtyrë në lidhje me njësitë e njohura jashtë fitimit ose humbjes njihet jashtë pasqyrave të fitimit ose humbjes. Zërat tatimore të shtyrë njihen në korrelacion me transaksionin me të cilin lidhen ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapital.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen, nëqoftëse një e drejtë ligjërish e detyrueshme ekziston për të vendosur kompesimin e aktiveve tatimore aktuale ndaj tatimit mbi të ardhurat e pasiveve dhe tatimeve të shtyra që lidhen me të njëjtin entitet të tatueshëm dhe të njëjtin autoritet tatimor.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

e. Taksa (vazhdim)

Taksat mbi shitjet

Të ardhurat, shpenzimet dhe aktivet regjistrohen me vlerën neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, përveç:

- Kur taksa mbi shitjet vendoset në blerjen e aktiveve ose shërbimeve nuk është e kreditueshme nga autoritetet tatimore, në këtë rast taksa mbi shitjet është e njohur si pjesë e kostos së blerjes së aktiveve ose si pjesë e mjeteve shpenzuese.
- Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme që janë të ndërlidhura me shumën e shitjeve janë të tatueshme.

Vlera neto e TVSH e konvertuar nga (ose e paguar për), autoritetet tatimore përfshihet si pjesë e llogarive të pagueshme dhe të arkëtueshme në pasqyrën e pozicionit financiar.

f. Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet Afatgjata Materiale janë deklaruar me vlerën kontabël neto, pas zbritjes së amortizimit të akumuluar dhe/ose humbjeve të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kjo kosto përfshin kostot e zëvendësimit të një pjesë të tokës, ndërtesës, makinerive dhe pajisjeve dhe kostove të huamarrjes për një periudhë afat-gjatë të projekteve të ndërtimit nëqoftëse kriteret e njohjes përmbushen. Kur një pjesë e rëndësishme e tokës, ndërtesës, makinerive dhe pajisjeve kërkohet që të zëvendësohet me intervale, Shoqëria i njeht këto pjesë si aktive individuale me një jetë të dobishme dhe amortizim specifik respektiv. Po kështu, kur një rikonstrukcion me vlerë të konsiderueshme është kryer, kostot e tij njihen në vlerën e mbetur të tokës dhe pajisjeve si një zëvendësim nëse kriteret e njohjes janë përmbushur.

Të gjitha kostot e tjera të riparimit dhe mirëmbajtjes do të njihen në pasqyrat e të ardhurave atëherë kur ndodhin. Vlera aktuale e kostos së pritshme për çmontimin e aktivitet pas përdorimit të tij është përfshirë në koston e aktivitet përkatës, nëse kriteret e njohjes për një provigjon janë përmbushur.

Amortizimi llogaritet mbi një bazë lineare mbi jetëgjatësinë e aktiveve si vijon:

➤ Ndërtesa	12.5 deri në 35 vjet
➤ Makineri dhe pajisje	8 deri në 15 vjet
➤ Automjete	5 vjet
➤ Pajisje kompjuterike	4 vjet
➤ Mobilje	8 vjet

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale dhe çdo pjesë e rëndësishme e njohur në fillim, nuk njihet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit, ose kur nuk priten përfitime të ardhshme nga përdorimi ose nga shitja e tij.

Çdo fitim ose humbje që vjen nga mosnjohja (ç'regjistrimi) e aktivitet (llogaritur si diferencë mes të ardhurave nga pakësimi dhe vlerës kontabël të aktivitet), përfshihet në pasqyrën e të ardhurave kur aktivitet ç'regjistrohet.

Vlera e mbetur e aktivitet, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen çdo periudhë financiare, duke bërë ndryshimet e nevojshme sipas rastit.

Mirëmbajtja dhe riparimet

Shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparimet kryesore përfshijnë koston e zëvendësimit të aktiveve ose pjesëve të aktiveve dhe koston e riparimeve. Kur një aktiv ose pjesë e një aktivitet që është amortizuar pjesërisht dhe që është fshirë përfundimisht dhe zëvendësuar me një tjetër, dhe është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike të ndërlidhura me objektin do t'i vijë Shoqërisë përgjatë jetës së saj të zgjatuar, në këtë mënyrë shpenzimi kapitalizohet.

Kur pjesë e një aktivitet nuk konsiderohet në mënyrë të ndarë si një komponent, vlera e zëvendësimit përdoret për të parashikuar totalin e vlerës së aktivitet që zëvendësohet i cili fshihet menjëherë. Të gjitha shpenzimet e tjera për mirëmbajtjen që ndodhin në përditshmëri shënohen si shpenzime në momentin që ndodhin.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g. Kostot e shtyra të nxjerrjes së mineralit – Aktive Afatgjata të Shtyra

Kostot e shtyra të nxjerrjes së mineralit që ndodhin gjatë zhvillimit të një miniere përpara fillimit të prodhimit, kapitalizohet si pjesë e kostos së ndërtimit të minierës dhe rrjedhimisht amortizohet mbi bazë lineare përgjatë jetës së minierës.

Kostot e gërmimit që akumulohen përgjatë fazës së prodhimit, shtyhen përgjatë ushtrimit të aktiviteteve operative sepse kjo është baza më e përshtatshme për të ndërlidhur kostot kundrejt përfitimit ekonomik që këto sjellin dhe ky efekt është material. Kryesisht ky është rasti kur ka devijacion në kostot e gërmimit në jetëgjatësinë e minierës. Vlera e kostove të gërmimit ndryshon në bazë të kostos aktuale që vjen si pasojë e gërmimit derisa arrihet zbulimi i mineraleve. Ky ndryshim i kostove i atribuohet më pas fitimit ose humbjes bazuar në sasinë e mineraleve të nxjerra nga niveli i arrirë respektivisht. Ndryshimet njihen në datën kur këto ndryshime bëhen të njohura. Kostot e ndryshuara të gërmimit janë përfshirë si pjesë e "aktiveve afatgjata të shtyra". Kjo bën pjesë në totalin e investimit për gjenerimin e mjeteve financiare, të cilat rishikohen për pasaktësi nëse evente të caktuara ose ndryshime në rrethana tregojnë që vlera totale që ajo mbart nuk mund të arrihet të rimerret e gjitha.

h. Kostoja e rehabilitimit të vendit

Shoqëritë e minierave zakonisht pësojnë kosto të konsiderueshme në vendin e minierës pasi mineralet janë nxjerrë dhe miniera është mbyllur. Një kosto e tillë përfshin ato për të hequr impiantin dhe objektet e tjera dhe për të rikthyer zonën në një mënyrë të kërkuar nga ligji.

Në vitin 1999, Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit lëshoi SNK 37 provizione, detyrime të kushtëzuara dhe asete të kushtëzuara, këto standarde përcaktojnë që një provizion duhet të njihet vetëm kur plotësohen të gjitha kriteret e mëposhtme:

- Një njësi ekonomike ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarje të kaluar.
- Është e mundshme që një rrjedhje e burimeve që përmbajnë përfitime ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin.
- Mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i provizioneve.

Duke marrë parasysh që të gjitha këto kushte janë përmbushur, në fund të vitit 2020 Shoqëria ka njohur një provizion për koston e rehabilitimit, mbi baza skontimi dhe e ka përfshirë këtë shumë në koston e aktiveve që do të zhvlerësohen gjatë jetës së marrëveshjes së koncesionit.

i. Qiratë

i. Aktive me të drejtë përdorimi

Shoqëria jep me qira automjete dhe ndërtesa.

Shoqëria njeh një aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë (p.sh. data kur aktivi është i gatshëm për përdorim). Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi dhe ndonjë korigjim për rimatjet e detyrimit të qirasë. Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi përfshin detyrimin e qirasë së njohur, kostot direkte dhe pagesat e qirasë të bëra në/përpara datës së fillimit, minus ndonjë incentive të marrë. Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet me metodën lineare për periudhën më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Ndërtesa dhe makineri	3 deri në 15 vjet
Automjete dhe pajisje të tjera	3 deri në 5 vjet

Nëse aktivi me qira transferohet në pronësi të Shoqërisë në fund të periudhës së qirasë ose kosto reflekton opsionin e blerjes, amortizimi llogaritet me jetëgjatësinë e dobishme të aktivit.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

i. Qiratë (vazhdim)

ii) Detyrimi i qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njih një detyrim të qirasë së matur me vlerën aktuale të pagesave të qirasë përgjatë periudhës së qiramarrjes. Pagesat, përfshijnë pagesat fikse minus ndonjë incentive të marrë, pagesat variabel që varen nga indekse apo norma dhe vlera e pritshme për tu paguar sipas vlerës së garancisë. Në vlerën aktuale të pagesave të qirasë, shoqëria përdor normën rritëse të qiramarrjes në datën e fillimit të qirasë, sepse norma e implicite e qirasë nuk është e mundur të përllogaritet. Pas datës së fillimit vlera e detyrimit të qirasë rritet duke reflektuar interesin e përllogaritur dhe zvogëlohet me pagesat e qirasë. Vlera kontabël e detyrimit të qirasë do të rishikohet nëse ka ndonjë modifikim, ndryshim afati, ndryshim pagese ose një ndryshim në vlerësimin e opsionit të blerjes së aktivit.

Pagesat e qirasë zbriten duke përdorur një normë të vetme skontimi për të gjithë portofolin e qirasë me të njëjtat karakteristika, shoqëruar me normat e huamarrjes të llogaritura në nivelin e Grupit. Shkalla mesatare e huamarrjes e përdorur për skontimin e qirave me maturitet 1-2 vjet: 3.00% dhe për një maturim 3-5 vjet: 3.21%.

Pas datës së fillimit, shuma e detyrimeve të qirasë rritet për të reflektuar mbledhjen e interesit dhe zvogëlohet për pagesat e qirasë të bëra.

Për më tepër, vlera kontabël e detyrimeve të qirasë ri-matet nëse ka një modifikim, një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (p.sh., ndryshimet në pagesat e ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar të tilla pagesa të qirasë) ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë aktivin.

Pagesat e qirasë alokohen ndërmjet kostos kryesore dhe kostos financiare. Kostot financiare njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë konstante periodike interesi për pjesën e mbetur të pasivit për secilën periudhë.

Pagesat e shoqëruara me qiratë afatshkurtra dhe të gjitha qiratë e aktiveve me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si një shpenzim në fitim ose humbje. Qira afatshkurtra janë qira me prej 12 muajsh ose më pak. Asetet me vlerë të ulët janë ato aktive me vlerë 5,000 Eur ose më pak.

Shoqëria si qiradhënëse

Qiratë në të cilat Shoqëria nuk transferon të gjitha risqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e aktivit janë klasifikuar si qira operacionale. Të ardhurat nga qiraja kontabilizohen me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së qirasë dhe përfshihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas natyrës së operacionit. Kostot fillestare direkte gjatë negociimit dhe caktimit të një qiraje operacionale i shtohen vlerës kontabël të aktivit të dhënë me qira dhe njihen përgjatë jetëgjatësisë së qirasë sipas së njëjtës metodë. Qiratë e kushtëzuara njihen si të ardhura në periudhën që ato përfitohen.

j. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivt afatgjata jomateriale të përfuara veçmas maten me koston fillestare të njohjes. Kostoja e një aktivit afatgjatë jomaterial të blerë në një kombinim biznesi, është vlera e drejtë në datën e blerjes. Duke ndjekur njohjen fillestare, aktivet afatgjata jomateriale mbahen me koston minus amortizimin e akumuluar, dhe zhvlerësimin e akumuluar, nëse ka.

Aktivt afatgjata jomateriale të gjeneruara nga biznesi, duke përjashtuar kostot e zhvillimit, nuk kapitalizohen dhe shpenzimet përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit në të cilin kanë ndodhur.

Aktivt afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuar amortizohen përgjatë jetës së tyre të dobishme ekonomike dhe i nënshtrohen testimit për zhvlerësim sa herë që ekziston një faktor që aktivit afatgjatë jomaterial duhet të zhvlerësohet. Periudha dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuar, rishikohet të paktën çdo fund periudhe raportimi. Ndryshimet në jetën e dobishme të pritshme ose në modelin e pritshëm të konsumimit të përfitimeve ekonomike të ardhshme të përfshira në aktiv llogariten duke ndryshuar metodën ose periudhën e amortizimit, siç është e përshtatshme, dhe trajtohen si ndryshim në vlerësimet kontabël. Shpenzimet e amortizimit të aktiveve afatgjata jomateriale së jetës të dobishme të përcaktuar njihen në pasqyrën e të ardhurave në kategorinë e shpenzimeve bazuar në funksionin e aktivit afatgjatë jomaterial.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

j. Aktivet afatgjata jomateriale (vazhdim)

Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuar është si më poshtë:

Tarifat e konçesionit - 40 vjet

Certifikata e Pajtueshmerise Reach – 24.25 vjet

Programi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore – 5 vjet

Rehabilitimi i mjedisit minerar – 20 vjet

Fitimi apo humbja nga mosnjohja (çregjistrimi) i një aktiviteti afatgjatë jomaterial, matet si diferencë mes të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël të aktivitetit. Këto të ardhura njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktiviteti çregjistrohet.

k. Inventarët

Inventarët, të cilët përbëhen nga mallra të gatshëm (Ferrokrom), lëndë të parë, inventarë të tjerë, maten ose vlerësohen fizikisht dhe vlerësohen me koston më të ulët dhe vlerën e realizueshme neto.

Kostot e nevojshme për sjelljen e produkteve në vendndodhjen dhe kushtet e tyre aktuale kontabilizohen si më poshtë:

Lëndët e para - Me koston e blerjes me metodën FIFO (First In-First Out).

Produktet e gatshme dhe prodhimi në proces - Me koston e punës dhe materialeve direkte dhe një pjesë të shpenzimeve të tjera të përgjithshme bazuar në kapacitetin normal prodhues, por duke përjashtuar kostot e huamarrjes. Kosto fillestare e inventarit përfshin transferimin e fitimit apo të humbjes, rezultuar nga ndërmarrja e pozicioneve mbrojtëse të fluksit monetar, të njohura në fitim-humbje, në lidhje me blerjet e lëndëve të para.

Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuar të përfundimit të procesit të prodhimit dhe kostot e vlerësuar të nevojshme për të kryer shitjen.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

I. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëqoftëse ka tregues se aktivet mund të jenë zhvlerësuar. Në rast se ekziston një tregues i tillë, ose kur testimi vjetor për një aktiv të zhvlerësuar kërkohet, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e aktivit është vlera me e lartë mes vlerës së drejtë të njësisë së gjenerimit të mjeteve monetare minus kostos së shitjes dhe vlerës në përdorim të aktivit, dhe përcaktohet për një aktiv individual, përveçse kur aktivin nuk gjeneron flukse monetare hyrëse të cilat janë më se shumti të pavaruara nga flukset monetare hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të aktiveve të shoqërisë. Kur vlera kontabël e një aktivit ose e njësisë së gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon shumën e vlerës së rikuperueshme, aktivin konsiderohet i zhvlerësuar dhe vlera e tij zvogëlohet deri në vlerën e tij të rikuperueshme.

Gjatë përcaktimit të shumës në përdorim, flukset e pritshme monetare skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur normën e zbritjes para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike për këtë aktiv. Në përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostove të transaksionit, merren në konsideratë transaksionet më të fundit në treg, në rast se ka të tilla. Në rast se transaksione të tilla nuk identifikohen, përdoret një model i përshtatshëm vlerësimi. Këto llogaritje mbështeten nga vlerësime të shumëfishta, çmimet e aksioneve të kuotuar për filialet e tregtuara në bursa, ose tregues të tjerë të vlerës së drejtë.

Shoqëria e bazon llogaritjen e zhvlerësimit në buxhete të detajuara dhe parashikime të cilat janë përgatitur veçmas për çdo njësi të gjenerimit të mjeteve monetare të shoqërisë, të cilat janë të alokuar aktivet individuale. Buxhetet dhe parashikimet përgjithësisht mbulojnë një periudhë pesë vjeçare. Për periudha më të gjata llogaritet një normë afatgjatë rritjeje dhe aplikohet në skontimin e flukseve monetare të ardhshme pas vitit të pestë.

Humbjet nga zhvlerësimi për operacionet e vazhdueshme, duke përfshirë zhvlerësimet në inventar, njihen në pasqyrën e të ardhurave në ato kategori shpenzimesh në përputhje me funksionin e aktivit të zhvlerësuar, përveç pronave të rivlerësuar paraprakisht kur rivlerësimi është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Në këtë rast zhvlerësimi njihet gjithashtu në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në shumën e ndonjë rivlerësimi të mëparshëm.

Për aktivet më përjashtim të emrit të mirë, bëhet një vlerësim në çdo datë raportimi në rast se ka ndonjë tregues që tregon që humbjet nga zhvlerësimet nuk ekzistojnë ose janë ulur.

Nëse ekzistojnë tregues të tillë, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivit ose të njësisë të gjenerimit të mjeteve monetare. Humbjet e mëparshme të zhvlerësimit mund të kthehen vetëm nëqoftëse ka pasur një ndryshim në supozimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivit që nga njohja e fundit e humbjes nga zhvlerësimi. Ky kthim është i kufizuar në mënyrë që shuma e mbartur e aktivit as të mos kalojë shumën e rikuperueshme dhe as të mos tejkalojë shumën e mbartur e cila do të ishte e përcaktuar, si amortizim neto, në rast se asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk do të ishte njohur për aktivin në vitet e mëparshme. Ky kthim njihet në pasqyrën e të ardhurave përveçse kur aktivin mbahet me vlerën e rivlerësuar të aktivit, rast në të cilin rikthimi trajtohet si një rritje nga rivlerësimi.

Aktivitet e mëposhtme kanë karakteristika specifike për testimet e zhvlerësimit:

Aktivitet jomateriale

Aktivitet jo-materiale me jetëgjatësi të dobishme të papërcaktuar testohen për zhvlerësim çdo vit më 31 dhjetor ose individualisht ose në nivelin e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, siç është e përshtatshme dhe kur rrethanat tregojnë se vlera e mbartur mund të jetë zhvlerësuar.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

m. Instrumentat Financiar

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, paratë dhe ekuivalentët e tyre, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera, të arkëtueshme dhe të pagueshme nga palët e lidhura.

Aktivët Financiare

i) Njohja fillestare dhe matja

Aktivët financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, dhe me pas maten me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit dhe të humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) dhe me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Shoqëria nuk ka identifikuar instrumenta financiare që përmbajnë një përbërës të rëndësishëm financimi.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ai duhet të krijojë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI) për shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim quhet test SPPI dhe kryhet në nivel instrumenti financiar.

Modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si menaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare. Shoqëria ka aktive financiare të arkëtueshme tregtare nga të cilat pret vetëm arkëtimin e principalit dhe interesit.

ii) Matja e mëpasshme

Për qëllime të matjes së mëpasshme, aktivët financiarë klasifikohen në katër kategori:

- Aktivët financiarë me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit);
- Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes OCI me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit);
- Aktivët financiarë të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes OCI pa riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e çregjistrimit (instrumentat e kapitalit neto);
- Aktivët financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

iii) Aktivët financiarë me koston e amortizuar

Shoqëria ka aktive financiare vetëm të kategorisë së parë. Shoqëria mat aktivët financiarë me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të aktivit financiar të japin rritje në data të përcaktuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

Aktivët financiarë me koston e amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (në qoftë se me kamatë) dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlerësimi). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Aktivët financiarë të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme.

iv) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar. Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

n. Instrumentat Financiar (vazhdim)

v) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Shoqëria merr parasysh supozimin e SNRF se një aktiv financiar konsiderohet borxh i keq kur pagesat kontraktuale janë 90 ditë me vonesë, megjithatë gjykimi bëhet rast pas rasti. Një aktiv financiar hiqet nga librat kontabël kur nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e flukseve monetare kontraktuale.

Për llogaritë e arkëtueshme, Shoqëria përdor metodën e thjeshtëzuar të përlllogaritjes së humbjeve të pritshme. Si rrjedhim, Shoqëria nuk ruan ndryshimet në riskun e kredisë, por përlllogarit një provigjon për llogari të dyshimta bazuar mbi humbjet e pritshme të përjetshme në cdo datë raportimi. Shoqëria ka krijuar një matricë provigjoni e cila bazohet në historikun e saj të humbjeve, e modifikuar për efektin e faktorëve të ardhshëm, të cilët janë specifike për klientet dhe mjedisin ekonomik në të cilin operon. Krahas matricës së provigjonit, Shoqëria përdorë gjithashtu një analize specifike mbi baza individuale klientësh të cilët kanë plotësuar përkufizimin për tu konsideruar si borxh i keq sipas analizes së matricës së provigjoni por për të cilat gjykohet individualisht në rast se kanë pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e flukseve monetare kontraktuale, nuk do të njohet provigjon për borxhin e keq.

Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre

Paratë dhe depozitat afatshkurtra në pasqyrën e pozicionit financiar përbëhen nga vlera monetare në banka, në arkë dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet tre mujor ose më pak. Për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra të përcaktuara më lart, pasi i zbritet teprica e overdrafteve bankare.

Detyrimet Financiare

Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kreditë dhe huamarrjet, të pagueshme ose si derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive, sipas rastit.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe të pagueshmeve, neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare, kreditë bankare dhe dhe hua të tjera të pagueshme të cilat janë të gjitha klasifikuar si të mbajtura me kosto të amortizuar.

vi) Matjet e mëvonshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- Detyrimet financiare maten me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- Me kosto të amortizuar.

Shoqëria nuk mban asnjë detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

vii) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohet, anulohen ose kur skadojnë. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës me kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues i janë modifikuar në mënyrë thelbësore, një shkëmbim ose modifikim i tillë trajtohet si një çregjistrimin e detyrimit origjinal dhe njohja e një detyrimi të ri dhe diferenca në vlerat përkatëse kontabël njihet si fitim ose humbje.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë cdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare kompesohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar nëse ekziston një e drejtë ligjore e zbatueshme aktualisht për të kompensuar shumat e njohura dhe një qëllim për të shlyer në një bazë neto, për të realizuar aktivet dhe për të shlyer detyrimet njëkohësisht.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABEL (VAZHDIM)

o. Huamarrjet

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, që përgjithësisht përkon me koston direkte të transaksionit, pra vlerën në para të përfituar.

Pas njohjes fillestare, huamarrjet maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose me koston e amortizuar. Huamarrjet do të çregjistrohen kur ripaguhen, anulohen ose kushtet kontraktuale ndryshojnë thelbësisht, e cila shoqërohet me njohjen e një huamarrje të re.

p. Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi, që kërkojnë një kohë të rëndësishme për të përgatitur aktivin për përdorim apo për shitje, kapitalizohen si pjesë e kostove të aktivit përkatës. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes, përfshihen në shpenzimet e periudhës në të cilën ndodhin. Kostot e huamarrjes përbëhen nga interesa dhe kosto të tjera në lidhje me huamarrjen e fondeve.

q. Përfitimet e punonjësve

Pensioni i detyrueshëm

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve për të kontribuar në planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostoja që ndodh për këto plane i takojnë Shoqërisë dhe fillimisht kapitalizohet në vlerën e inventarit dhe më pas për çdo dalje inventari i ngarkohen në fitimin ose humbjen respektive brenda vitit ushtrimor.

Leje vjetoree paguar

Shoqëria njih si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhur me lejen vjetore e cila pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën e kryer.

Sigurimi i shëndetit të punonjësve

Shoqëria është e angazhuar në një plan të përcaktuar për sigurimin e jetës nga aksidentet për punonjësit e saj. Kontributi është i pagueshëm kundrejt një Shoqërie sigurimi kryesisht për punonjësit e minierës që ofrojnë shërbimet e tyre për Shoqërinë dhe njihet si shpenzim i periudhës. Shoqëria shlyen detyrimin me pagesa fikse për një periudhë një vjeçare dhe nuk ka asnjë detyrim tjetër kundrejt shoqërive të sigurimit të jetës nga aksidentet në fund të vitit.

Plani me përfitime të përcaktuar

Bazuar në Marrëveshjen Kolektive të Punës në Albchrome, disa punonjës kanë të drejta sipas planit të pensionit të Shoqërisë, të cilat janë përcaktuar në planin e përfitimit nga fondi i pensioneve.

Për planet e përfitimit nga fondi i pensioneve, niveli i përfitimeve të siguruar bazohet në kohëzgjatjen e shërbimit dhe fitimet e personit të drejtë.

Kostoja e planit të përfitimit nga fondi i pensioneve përcaktohet duke përdorur metodën e projekcionit të kreditit të njësisë. Detyrimi i lidhur me pensionin në njohur në pasqyrën e pozicionit financiar është vlera aktuale e detyrimit të përfitimit nga ky fond.

Shoqëria merr vlerësimin aktual për planin e përfitimit nga fondi i pensionit. Supozimi aktuarial i përdorur në përcaktimin e detyrimeve të planit të përfitimit bazohet në vlerësimet më të mira, përfshirë shkallën e pagave dhe datat e pensionit të pritshëm të punonjësve. Shkalla e skontimit bazohet në normën e interesit në bonot e thesarit 10 vjeçare të emetuara nga qeveria në Shqipëri.

SNK 19 kërkon që kostot e një plani të vetëm përfitimi nga punëdhënësi t'i atribuohen periudhave të shërbimit të punonjësve, pra, të llogariten kur fitohen sesa kur paguhen.

Si rezultat, Shoqëria vlerësoi kërkesat e Standardit për të pasqyruar siç duhet planin e përfitimit nga fondi i pensioneve që i atribuohet vlerës detyrimit deri më 31 dhjetor 2020. Bazuar në argumentet e materialitetit dhe pa ndonjë ndikim thelbësor në përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare, Drejtimi ka marrë vendimi për të mos rishpallur pasqyrën e tij financiare të vitit 2020 siç kërkohet nga SNK 8 por për të "ri-paraqitur" efektin e vlerësuar të bilancit të hapjes drejtpërdrejt të gabimit si lëvizje në kapitalin e vet.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

r. Provizionet

Të përgjithshme

Provizionet janë njohur kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarje të kaluar, është e mundur që të nevojiten flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Kur Shoqëria pret që disa ose të gjitha provizionet të rimbursohen, p.sh nën një kontratë sigurimi, rimbursimi njihet si një aktiv i vecantë, por vetëm kur rimbursimi është i sigurt. Shpenzimet e lidhura me provizionet paraqiten në Pasqyrën e të Ardhurave neto nga çfarëdo rimbursim (duke i zbritur shumat e rimbursuara).

Provizione për çështje gjyqësore

Shoqëria ka njohur provigjone për çështje të hapura gjyqësore me palë të treta për të cilat ka vlerësuar se flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer detyrimet do të rrjedhin në periudhat e ardhshme bazuar kjo në metodën e probabilitetit të mundshëm. Shoqëria do të rrimarë këto provigjone vetëm kur të shpallen vendimet e formës së prerë në favor të saj nga institucionet gjyqësore.

s. Ngjarjet pas datës së bilancit

Disa ndryshime dhe interpretime zbatohen për herë të parë në vitin 2020, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë, përfshirë ndryshimin e SNK 1, i cili përshkruhet në disa detaje më poshtë. Shoqëria nuk ka miratuar më herët ndonjë standard, interpretim ose ndryshim që është lëshuar, por nuk janë ende efektive.

t. Ndryshimet në politikat e rëndësishme të kontabilitetit

Disa ndryshime dhe interpretime zbatohen për herë të parë në vitin 2020, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë, përfshirë ndryshimin e SNK 1, i cili përshkruhet në disa detaje më poshtë. Shoqëria nuk ka miratuar herët ndonjë standard, interpretim ose ndryshim që është lëshuar, por nuk janë ende efektive.

- **SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet: Përkufizimi i 'materialit' (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020 me zbatim më të hershme. Ndryshimet sqarojnë përkufizimin e materialit dhe mënyrën se si duhet të zbatohet. Në përkufizimin e ri thuhet se, 'Informacioni është material nëse heqja, keqdeklarimi ose fshehja, mund të pritet që të ndikojë në vendimet e përdoruesve kryesorë të pasqyrave financiare me qëllim e përgjithshëm bëjnë në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat ofrojnë informacion rreth subjektit raportues'.

Për më tepër, shpjegimet që shoqërojnë përkufizimin janë përmirësuar. Ndryshimet gjithashtu sigurojnë që përcaktimi i materialit të jetë konsistent në të gjithë Standardet e SNRF-ve.

Drejtimi ka bërë një vlerësim të efektit të standardit dhe konsideron se standardi i ri nuk ka efekt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Standardet, ndryshimet dhe përmirësimet e mëposhtme të reja janë bërë efektive në 1 Janar 2020 megjithatë nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë.

- *Ndryshimet në SNRF 3: Kombinimet e Biznesit*
- *Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7: Reforma e Vlerësimit të Normës së Interesit*
- *Ndryshimet në Kornizën Konceptuale të SNRF-ve*

- **SNRF 16 Qiratë - Koncesione Qiraje të Lidhura me Covid-19 (Ndryshim)**

Ndryshimi zbatohet, në retrospektivë, për periudhat të raportimit që fillojnë më ose pas 1 qershorit 2020. Zbatimi i mëparshëm është i lejuar, përfshirë në pasqyrat financiare ende të paautorizuara për tu lëshuar në 28 maj 2020. IASB ndryshoi standardin për t'u dhënë lehtësim qiramarrësve nga zbatimi i SNRF 16 udhëzime për kontabilitetin e modifikimit të qirasë për koncesionet e qirasë që vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë covid-19. Ndryshimi siguron një lehtësi praktike që qiramarrësi të marrë parasysh çdo ndryshim në pagesat e qirasë që rezultojnë nga koncesioni e qirasë në lidhje me covid-19 në të njëjtën mënyrë që do të llogariste ndryshimin sipas SNRF 16, nëse ndryshimi nuk ishte një modifikim i qirasë, vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

r. Ndryshimet në politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

- Ndryshimi në pagesat e qirasë merr në konsideratë rishikimin për qiranë që është në thelb e njëjtë me, ose më pak se, shpërblimin për qiranë menjëherë para ndryshimit.
- Çdo ulje e pagesave të qirasë ndikon vetëm në pagesat që fillimisht u paguan më ose para 30 Qershorit 2021.
- Nuk ka asnjë ndryshim thelbësor në termat dhe kushtet e tjera të qirasë.

(i) Standardet dhe ndryshimet e nxjerra por jo ende efektive dhe të pazbatuara më herët

Standardet dhe ndryshimet e mëposhtme do të miratohen nga Shoqëria kur ato të bëhen efektive, megjithatë, këto nuk do të kenë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNK 1: Prezantimi i Pasqyrave Financiare: Detyrimet afatshkurtër dhe afatgjatë (Ndryshimet)** - efektive për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023
- **Reforma e Vlerësimit të Normës së Interesit - SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 & SNRF 16 (Ndryshimet) - Faza 2**
- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivët afatgjatë materiale; SNK 37 Provigjione, Detyrime të Kushtëzuara dhe Aktive të Kushtëzuara si dhe Përmirësime Vjetore 2018-2020 (Ndryshimet)**

(ii) Standardet dhe ndryshimet e nxjerra por jo ende efektive dhe jo të miratuara më herët

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me leje të aplikimit të mëparshëm. BSNK ka lëshuar ndryshime me standarde të ngushta në Standardet e SNRF si më poshtë:

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimet)** azhurnojnë një referencë në SNRF 3 në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar pa ndryshuar kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit.
- **SNK 16 Prona, Impiantet dhe Pajisjet (Ndryshimet)** ndalojnë një Shoqëri të zbrisë nga kostoja e aktiveve afatgjatë materiale të marra nga shitja e artikujve të prodhuar ndërsa Shoqëria po përgatit aktivin për përdorimin e tij të synuar. Në vend të kësaj, një Shoqëri do të njohë të ardhurat e tilla të shitjeve dhe koston e lidhur në fitim ose humbje.
- **SNK 37 Provigjionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara (Ndryshimet)** specifikojnë se cilat kosto përfshin një Shoqëri në përcaktimin e koston së përbushjes së një kontrate për qëllimin e vlerësimit nëse një kontratë është e vështirë.
- **Përmirësimet Vjetore 2018-2020** sjellin ndryshime të vogla në SNRF 1 Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNK 41 Bujqësia dhe Shembuj ilustrues që shoqërojnë SNRF 16 Qiratë.

t. Gjykime të rëndësishme kontabël, vlerësime dhe supozime

Përgatitja e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve dhe dhënies së shpjegimeve për detyrimet e kushtëzuara, në fund të periudhës raportuese. Megjithatë, pasiguria në lidhje me këto supozime dhe vlerësime mund të rezultojë në ngjarje që kërkojnë korrigjime materiale në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit që do të rezultojë në periudhat e ardhshme.

Vlerësime dhe supozime

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen dhe burime të tjera kyçe të pasigurisë në vlerësimet në periudhën raportuese, që kanë një risk të madh të shkaktimit të një korrigjimi material të vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve në vitin e ardhshëm financiar, janë përshkruar më poshtë. Shoqëria i bazon supozimet dhe vlerësimet mbi parametrat që ka pasur në dispozicion kur janë përgatitur pasqyrat financiare. Rrethanat ekzistuese dhe supozimet në lidhje me zhvillimet e ardhshme mund të ndryshojë për shkak të ndryshimeve të tregut ose nga rrethanat që dalin jashtë kontrollit të shoqërisë. Këto ndryshime janë reflektuar në supozimet kur ato ndodhin.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

t. Gjykime të rëndësishme kontabël, vlerësime dhe supozime (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Një zhvlerësim ekziston kur vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë së gjenerimit të parasë tejkalon shumën e tij të rikuperueshme, e cila është shuma më e lartë mes vlerës së drejtë minus kostos së shitjes dhe vlerës së tij në përdorim.

Llogaritja e vlerës së drejtë minus kostot për shitje bazohet në të dhënat në dispozicion nga transaksionet e shitjes në kushte normale aktiviteti për aktive të ngjashme ose nga çmime të observueshme tregu minus kostot shtesë për shitjen e aktivitetit ose nxjerrjen jashtë përdorimit të tij. Llogaritja e vlerës në përdorim është bazuar në modelin e skontimit të flukseve monetare. Flukset e mjeteve monetare janë bazuar te buxheti për pesë vitet e ardhshme dhe nuk përfshijnë veprimtaritë ristrukturuese që shoqëria nuk është angazhuar ende ose investime të rëndësishme në të ardhmen që do të rrisin performancën e aktiveve të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare në testim.

Shuma e rikuperueshme është më e ndjeshme ndaj normës së skontimit të përdorur në modelin e skontimit të flukseve të parasë si edhe të flukseve të pritshme monetare në të ardhmen dhe normës së rritjes që përdoren për qëllime ekstrapolimi.

Shpenzime gjurmimi të shtyra

Shoqëria e fokusuar në industrinë e minierave shtyn kostot e ardhshme të gjurmimit të shkaktuara gjatë fazës së prodhimit të operacioneve të saj. Kjo llogaritje kërkon përdorimin e gjykimeve dhe vlerësimeve të tilla si llogaritjet në ton të mbetjeve për t'u hequr gjatë jetës së zonës minerare dhe si rezultat i rezervave nxjerra. Ndryshimet në jetën e dobishme dhe modelin e një miniere zakonisht rezultojnë në ndryshime në normën e pritshëm të gjurmimit.

Kërkohej një gjykim i rëndësishëm për të bërë dallimin midis kostos së zhvillimit për gjurmimin dhe kostos së prodhimit dhe për të bërë dallimin midis kostos së prodhimit që lidhen me nxjerrjen e inventarit dhe asaj që lidhet me krijimin e një aktivi nga aktiviteti i gjurmimit.

Pasi Shoqëria ka identifikuar kostot e saj të prodhimit për secilin operacion të minierave sipërfaqësore, ajo identifikon përbërësit e veçantë të kromit për secilin nga operacionet e saj të minierave. Një përbërës i identifikueshëm është një vëllim specifik i kromit që bëhet më i arritshëm nga aktiviteti i gjurmimit. Kërkohej një gjykim i rëndësishëm për të identifikuar dhe përcaktuar këto përbërës, dhe gjithashtu për të përcaktuar vëllimet e pritshme (p.sh., në ton) të mbetjeve nga gjurmimi dhe kormit që do të minohet në secilin prej këtyre përbërësve. Këto vlerësime janë ndërmarrë për secilin operacion individual të minierave bazuar në informacionin e disponueshëm në planin e minierave. Identifikimi i përbërësve, do të ndryshojnë midis minierave për një numër arsyesh. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në, karakteristikat gjeologjike të trupit kormit, vendndodhjen gjeografike dhe / ose konsideratat financiare.

Gjykimi kërkohej gjithashtu për të identifikuar një masë të përshtatshme prodhimi që do të përdoret për të alokuar kostot e gjurmimit midis inventarit dhe çdo aktivi nga aktiviteti i gjurmimit për secilin përbërës. Kompania zbaton metodën UOP në përcaktimin e jetëgjatësisë së aktivitetit (ve) të aktivitetit të gjurmimit. Referojuni Shënimit 14 për më shumë informacion.

Provizionet për humbjet e pritshme të kredisë

Shoqëria përdor një matricë provizionit për të llogaritur HPK për të arkëtueshmet tregtare. Normat e provizioneve bazohen në ditët e kaluara për grupime të segmenteve të ndryshme të klientëve që kanë modele të ngjashme humbjesh (p.sh., nga gjeografia, lloji i produktit, lloji i klientit dhe / ose vlerësimi, dhe mbulimi nga letrat e kredisë dhe format e tjera të sigurimit të kredisë).

Matrica e provizionit fillimisht bazohet në normat historike të vëzhguara të Shoqërisë. Shoqëria do të përdori matricën për të rregulluar përvojën historike të humbjes së kredisë me informacionin e ardhshëm. Për shembull, nëse kushtet ekonomike të parashikuara pritet të përkeqësohen gjatë vitit të ardhshëm, gjë që mund të çojë në një numër në rritje të mospagimeve, normat historike të provizionit rregullohen. Në çdo datë raportimi, normat historike të provizionit azhurnohen dhe analizohen me vlerësime parashikuese.

Vlerësimi i korrelacionit midis normave historike të vëzhguara të paracaktuar, kushteve ekonomike të parashikuara dhe HPK është një vlerësim domethënës. Shuma e HPK-ve është e ndjeshme ndaj

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

t. Gjykime të rëndësishme kontabël, vlerësime dhe supozime (vazhdim)

ndryshimeve në rrethana dhe parashikimit të kushteve ekonomike. Përvoja historike e humbjes së kredisë së Shoqërisë dhe parashikimi i kushteve ekonomike gjithashtu nuk mund të jenë përfaqësuese e aftesisë paguese të klientit në të ardhmen.

Taksat

Pasiguri ekziston në lidhje me interpretimin e rregulloreve komplekse të taksave, ndryshimeve në ligjet tatimore, si dhe shumës dhe kohës së të ardhurave të ardhshme të tatueshme. Duke qënë se ekziston një gamë e gjerë e marrëdhënieve të biznesit ndërkombëtar si dhe një natyrë afatgjatë dhe kompleksitet i marrëveshjeve ekzistuese kontraktuale, lindin diferenca midis rezultateve aktuale dhe supozimeve të bëra, ose, ndryshime të ardhshme të supozimeve mund të cojnë në nevojën e korigjimit të të ardhurave të tatueshme dhe shpenzimeve tashme të regjistruara.

Shoqëria krijon provigjone bazuar në vlerësime të arsyeshme lidhur me pasojat e mundshme nga auditime të kryera nga autoritetet tatimore të vendit në të cilin Shoqëria operon. Vlera e provigjoneve bazohet në disa faktorë, si psh: përvoja e mëparshme nga auditimet tatimore dhe interpretime të ndryshme të rregulloreve tatimore nga njëësia e tatueshme ose autoriteti përgjegjës tatimor.

Diferencat e interpretimeve mund të shkaktohen nga çështje të ndryshme që varen nga kushtet ekzistuese në mjedisin ku Shoqëria operon. Kur Shoqëria e vlerëson të ulët probabilitetin që një çështje gjyqësore e lidhur me taksat të rezultojë në flukse dalëse monetare, ajo nuk njuh detyrime të kushtëzuara. Aktivitetet e shtyra tatimore njihen për të gjitha humbjet e papërdorura tatimore deri në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm të mjaftoj për përdorimin e humbjeve. Për të përcaktuar vlerën e aktivitetit të shtyrë tatimor që do të njihet, duhet gjykim i konsiderueshëm nga manaxhimi, bazuar në kohën dhe vlerën e mundshme të fitimit të tatueshëm në të ardhmen, si dhe në strategjitë e planifikimit të tatimeve në të ardhmen.

Kostot për restaurimin e mjedisit

Shoqërisë i kërkohet që të restaurojë zonën e minierës ose vendet e punimeve në fund të jetës së tyre të prodhimit dhe t'i kthejë në një gjendje të pranueshme nga autoritetet përkatëse dhe konform politikave mjedisore të Shoqërisë. Provizionet për restaurimin e mjedisit njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv si rezultat i ndodhive në të kaluarën, si dhe është e mundshme që një pjesë e burimeve do të kërkohen për shlyerjen e detyrimit dhe vlera është llogaritur në mënyrë të besueshme.

Llogaritja e kostovë të ardhshme të këtyre detyrimeve është komplekse dhe kërkon manaxhimin të kryejë llogaritje dhe të përdorë gjykime sepse shumica e detyrimeve do të përbushen në të ardhmen dhe kontratat dhe ligjet zakonisht nuk janë të qarta përsa u përket atyre që kërkohen. Për më tepër, provizionet që krijohen ndikohen më tej nga nga ndryshimet në teknologji, konsideratat mjedisore, të sigurisë, biznesit, politik dhe ligjor.

Kostot që lidhen me aktivitetet restauruese llogariten me vlerën e tashme të të gjitha flukseve monetare që pritet të dalin në të ardhmen, dhe njihen si një aktiv më vete, brenda aktiveve afatgjata materiale dhe detyrimit përkatës. Kostoja e kapitalizuar amortizohet mbi jetën e dobishme të aktivitetit dhe cdo ndryshim në vlerën e tashme neto të detyrimit të pritshëm përfshihet në kostot financiare, përveçse kur ndryshimi në detyrim vjen si pasojë e ndryshimeve në gjykimet kontabël të vlerësimit.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në cdo periudhë të ardhme që ndikohet.

Në vecanti, informacioni rreth sferave të rëndësishme të pasigurisë në vlerësimet dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë më shumë efekt në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet e mëposhtme:

Shënimi 11 – Shpenzimi për tatimin mbi fitimin

Shënimi 12 – Aktiv tatimor i shtyrë

Shënimi 17 – Llogaritë e arkëtueshme

Shënimi 28 – Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**u. Menaxhimi i rrezikut financiar**

Shoqëria ka ekspozim kundrejt rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të tregut nga përdorimi i instrumentave financiare. Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimet e shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme; objektivat, politikat dhe proceset e shoqërisë për të matur dhe manaxhuar rrezikun; si dhe manaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Shënime të mëtejshme shpjeguese sasiore janë përfshirë në pasqyrat financiare dhe vecanërisht në shënimin 25. Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikqyrjen e strukturës së shoqërisë për manaxhimin e rrezikut.

Politikat e Shoqërisë për manaxhimin e rrezikut janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rrezikun me të cilat përballet Shoqëria, për të përcaktuar kufij dhe kontrole rreziku të përshtatshme, si dhe për të monitoruar rrezikun dhe zbatimin e kufijve të përcaktuar. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet e kushteve të tregut dhe të aktiviteteve të shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve, procedurave dhe standardeve të manaxhimit ka për qëllim të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin punonjësit kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Instrumentat kryesore financiare të shoqërisë lidhen me paranë në arkë ose bankë, huatë me palët e lidhura, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, si dhe të tjera të arkëtueshme dhe detyrime.

Rreziku i kredisë

Për shkak të volumit të madh dhe shumëllojshmërinë e bazës së klienteve të shoqërisë, përqëndrimet e rrezikut të kredisë në lidhje me llogaritë e arkëtueshme nga klientët janë të limituar. Zbritja (provigjoni) për llogaritë e dyshimta përcaktohet në një vlerë e cila konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqe potenciale në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme.

Rreziku i likuiditetit

Shoqëria gjeneron flukse monetare nga aktivitetet operative dhe beson se rreziku i likuiditetit nuk është i rëndësishëm.

*Rreziku i tregut**Rreziku i normës së interesit*

Shoqëria përballet me rrezikun e normës së interesit që lidhet me huatë nga aksionerët të cilat kanë një normë të ndryshueshme. Drejtimi nuk mban derivativë për të zbutur rrezikun.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria ka një ekspozim të madh kundrejt monedhave të huaja. Shoqëria ka hua afatshkurtra dhe afatgjata të denominuara në USD.

Analiza e ndjeshmërisë

Shoqëria ka për qëllim uljen e impaktit të luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë, ndërsa manaxhon rrezikun e normës së interesit dhe kursit të këmbimit. Në një periudhë afatgjatë, ndryshime të përhershme në kursin e këmbimit dhe normës së interesit kanë një impakt në fitim. Në 31 dhjetor 2014, është llogaritur se një ndryshim në përqindjen e normës së interesit të zërave në Lekë kundrejt monedhave të huaja do t'a impaktonte në mënyrë të konsiderueshme fitimin e shoqërisë përpara taksave.

Manaxhimi i kapitalit

Politika e shoqërisë është që të mbajë një bazë kapitali të fortë, si dhe të ketë besimin e investitorit, kreditorit dhe tregut për të mbështetur zhvillimet e biznesit në të ardhmen. Bordi i Drejtorëve monitoron kthimin mbi kapital, të cilin Shoqëria e përcakton si Të ardhura Operative neto përmbi Kapitalin e Vet. Gjithashtu, Bordi i Drejtorëve monitoron nivelin e dividendëve të aksionerëve të zakonshëm. Bordi kërkon të mbajë një ekuilibër midis kthimeve të larta të cilat janë të mundura me nivele më të larta të huave dhe avantazheve nga siguria e të pasurit një pozicion të mirë kapitali. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të jashme për kapitalin. Nuk ka pasur gjatë vitit ndryshime në trajtimin e manaxhimit të rrezikut financiar dhe kapitalit nga Shoqëria.

Periudhat krahasuese

Shifrat për periudhat krahasuese janë riklasifikuar ku është parë e përshtatshme, për të qënë në përputhje me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale. Këto riklasifikime, gjithsesi, nuk kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme në përmbajtjen dhe formën e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare.

Albchrome sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***3. TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTËT**

Shitjet e pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

Të ardhura nga kontratat me klientët	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shitje Ferro-krom HC	4.487.756	7.520.121
Shitje Materiale të tjera	2.453	3.711
Totali	4.490.208	7.523.832

Të ardhurat nga shitja e Ferrokromit njihen në një moment të caktuar në kohë kur Shoqëria transferon kontrollin e mineralit tek klienti. Gjatë vitit 2020 Shoqëria nuk ka kryer asnjë shitje apo eksport të mineralit të kromit, duke e përdorur të gjithë prodhimin për nevojat e saj përpunuese. Të ardhurat nga shërbimet e transportit të mallrave njihen përgjatë kohës që ofrohen shërbimet.

Informacione për të ardhurat e ndara

Më poshtë paraqitet ndarja e të ardhurave të Shoqërisë nga kontratat me klientët:

	Ferro Kromi	Mineral Kromi	Të tjera	Totali
Natyra e mallit/shërbimit				
Shitjet e mallrave të gatshme	4.419.382	-	-	4.419.382
Transporti	67.783	-	-	67.783
Sigurimi	591	-	-	592
Të tjera	-	-	2.453	2.453
Totali	4.487.756	-	2.453	4.490.209
Koha e njohjes së të ardhurave				
Transferuar në një moment në kohë	4.419.382	-	-	4.419.382
Transferuar me kalimin e kohës	68.374	-	2.453	70.827

4. TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhura të tjera në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga leje kalimi Zona D	35.817	36.185
Të ardhurat nga shitjet e skorjeve	5.069	26.751
Rimbursimi i shpenzimeve operative	3.123	1.734
Të ardhura nga zhvlerësimi i detyrimeve	2.245	1.676
Të ardhura të tjera	2.058	2.936
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjate	367	124
Rrimarje e provizioneve	-	13.461
Të ardhurat nga shitja e skrapit	-	6.576
Të ardhurat nga gjobat	-	3.739
Totali	48.679	93.182

Të ardhurat nga lejet e kalimit lidhen me kontrata të nënshkruar me subjekte të cilat shfrytëzojnë (për kalim) hapësirat të cilat Shoqëria i disponon në bazë të Marrëveshjes Koncensionare dhe Lejes Minerare.

Të ardhurat e tjera lidhen me rimbursim shpenzimesh nga palë të treta apo punonjës të Shoqërisë.

Albchrome sh.p.k.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***5. BLERJA E MATERIALEVE**

Kostoja e materialeve në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse është analizuar si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Viti mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Mineral kromi dhe koks	844.212	2.516.264
Energji elektrike	1.404.940	2.166.900
Materiale të tjera	330.416	433.580
Shpenzime të kapitalizuara	(249.295)	(368.222)
Totali	2.330.273	4.748.522

Materialet e tjera lidhen me materialet e konsumuara gjatë procesit të prodhimit si: elektroda, tuba oksigjeni, fletë çeliku, karburant dhe lubrifikant etj.

Shpenzimet e kapitalizuara lidhen me materiale të përdorura si pjesë e kostove të gërmimit në minierë.

6. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet për personelin në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019
- Bulqiza	577.196	572.238
- Elbasan	136.072	164.864
- Burrel	129.410	160.328
- Qafë Buall	119.813	114.605
- Tiranë	93.544	105.355
- Traverbank	-	37.931
- Klos	2.054	2.317
Pagat	1.058.089	1.157.638
- Bulqiza	100.533	98.045
- Elbasan	19.825	23.727
- Qafë Buall	19.889	18.596
- Burrel	18.992	22.812
- Traverbank	-	6.155
- Tiranë	11.512	8.002
- Klos	393	479
Sigurime Shoqërore	171.144	177.816
- Bulqiza	2.070	-
- Elbasan	438	-
- Burrel	285	-
Përfitimi i pensionit të punonjësve	2.793	-
- Bulqiza	14.617	14.385
- Elbasan	3.504	3.600
- Burrel	1.743	1.675
- Qafë Buall	1.273	1.363
- Traverbank	-	391
Transporti i punonjësve	21.137	21.414
Totali	1.253.163	1.356.868

Albchrome sh.p.k.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***6. SHPENZIME PERSONELI (VAZHDIM)**

Numri i punonjësve të Shoqërisë në fund të periudhës raportuese i paraqitur sipas njësive është për sa më poshtë:

Nr. Punonjësve	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
- Miniera Bulqizë	640	593
- UFK Elbasan	167	178
- UFK Burrel	150	167
- Miniera Qafë Buall	53	52
- Impianti Pasurimit Klos	5	5
- Zyrat Qëndrore Tiranë	38	34
Totali	1.053	1.029

7. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzime të përgjithshme dhe administrative në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shërbime transporti	127.262	163.003
Shërbime laboratorike dhe peshim	55.358	113.644
Shërbime sigurimi	54.340	54.756
Konsulencë financiare	35.501	52.187
Renta minerare	37.680	37.843
Siguracion	21.836	23.107
Provizion për llogaritë e arkëtueshme - HPK	14.847	-
Subvencione të dhëna	14.731	6.470
Taksa vendore	6.698	5.798
Shpenzime të tjera personeli	6.503	5.588
Shpenzime të tjera	4.016	15.076
Mirëmbajtje dhe riparime	3.975	2.030
Shpenzime pritjeje dhe përfaqësimi	3.577	6.428
Kancelari zyre dhe pastrimi	3.119	3.324
Qira	3.032	12.217
Shërbimet financiare	2.572	7.055
Telefon dhe shërbime postare	1.900	2.908
Udhëtime dhe akomodime	1.716	6.206
Shpenzimet e marketingut	1.098	6.416
Provizione për diferencën e inventarit	1.082	-
Shpenzime doganore	466	1.718
Penalitete	65	912
Totali	401.374	526.686

Shërbimet e transportit iu përkasin transportit të eksporteve për produktin e gatshëm dhe transportet brenda vendit. Gjithashtu shërbimet laboratorike për analizat dhe peshimi lidhen me tregtimin e produktit të gatshëm. Taksat përfshijnë rentën minerare e cila është llogaritur për sasinë e produktit të shitur dhe taksat vendore që iu paguhen bashkive.

Shpenzimet e tjera përfshijnë pagesat për tarifat e certifikatave të cilësisë, shpenzimet doganore, tarifa për shërbimet të ndryshme të njoftimit gazetë, shpenzime për pritje dhe përfaqësim, etj.

Gjatë vitit 2020, Shoqëria ka paguar anëtarët e Bordit të Drejtoreve në shumën 250 mijë lekë (2019: 1.523 mijë lekë).

Shoqëria ka marrë nga audituesi ligjor vetëm shërbime në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare në shumën prej 2.014 mijë lekë (2019: 2.330 mijë lekë).

Albchrome sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***8. AMORTIZIMI DHE ZHVLERËSIMI**

Amortizimi dhe zhvlerësimi në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse është analizuar si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale (Shënimi 13)	434.100	405.072
Amortizimi i shpenzimeve të shtyra për gërmime (Shënimi 14)	173.174	113.464
Amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorni (Shënimi 15)	23.998	24.314
Amortizimi i tarifave të konçesionit (Shënimi 13)	8.157	8.157
Amortizimi i aktiveve afatgjata jo-materiale (Shënimi 13)	655	655
Totali	640.084	551.662

9. FITIMI / (HUMBJA) NETO NGA KURSI I KËMBIMIT

Fitimet / (humbjet) neto nga kursi i këmbimit në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kanë të bëjnë kryesisht me operacionet dhe analizohen si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitimi nga kursi i këmbimit	473.132	297.006
Humbje nga kursi i këmbimit	(359.663)	(321.196)
(Humbja)/fitimi neto	113.469	(24.190)

10. SHPENZIMET PËR INTERESAT SHPENZIMET

Shpenzimet nga interesi në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse është analizuar si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime interesi për overdrafte	129.780	94.814
Shpenzime interesi për kredi me afat	13.497	24.202
Shpenzime të tjera për interesat	1.802	-
Shpenzime interesi për aktive me të drejtë përdorimi	1.690	2.348
Totali	146.769	121.364

11. TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas Legjislacionin fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018 15%). Tatimi i shtyrë llogaritet mbi diferencat e përkohshme duke përdorur normën prej 15% (2018: 15%).

Tatimi mbi fitimin në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse është analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Fitimi/(humbja) kontabël para tatimit	28.962	(786.786)
<i>Rregullime për qëllime të kontabilitetit:</i>		
Shpenzime shtesë të amortizimit për qëllime tatimore	85.505	(5.610)
Fitimi ligjor para tatimit	114.467	(792.785)
Shpenzime të pazbritshme	37.789	10.905
Të ardhura të tatueshme	5.463	(386)
Të ardhura të patatueshme	386	(56.731)
Fitimi/(humbja) i/e tatueshëm/e	158.105	(838.609)
Shpenzime për tatim fitimin 15% (2019 me 15%)	23.716	-

Në vitin 2020 dhe 2019, të ardhurat e tatueshme përfaqësojnë të ardhura të shtyra kontabël për tu njohur gjatë vitit në vijim që lidhen me mallra të eksportuara por të pa mbërritura ende në destinacionin, pra që nuk i përmbushin kushtet e njohjes së të ardhurave kontabël.

Albchrome sh.p.k.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***11. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)**

Përsa i përket trajtimit tatimor, Shoqëria ka llogaritur tatimin mbi fitimin në momentin e eksportimit, bazuar mbi dokumentat doganore. Të ardhurat e patatueshme iu përkasin të ardhurave të njohura për qëllime tatimore në vitin 2019 si dhe provigjone të ngritura të cilat nuk njihen si shpenzime të tatueshme.

Rakordimi midis normës efektive tatimore dhe shkallës tatimore të përdorur për qëllime të kontabilitetit ligjor jepet më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Norma e tatimit efektiv		Norma e tatimit efektiv	
Fitimi/(humbja) kontabël para tatimit	%	28.962	%	(786.786)
Sipas normës tatimore 15% (2019: 15%)	15%	4.344	15.00%	(118.018)
Efekt i tatimor për shpenzimet e pazbritshme	22.6%	6.546	0.88%	(6.932)
Shpenzime për tatim fitimin për vitin	37.6%	10.890	15.88%	(124.950)
	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
Fitimi/(humbja) kontabël		23.716		(125.791)
Diferenca në amortizim – tatimi i shtyrë		(12.826)		841
Fitimi tatimor		10.890		(124.950)

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për periudhën e treguar përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Totali për shpenzimin e tatim fitimit aktual	23.716	-
Tatimi fitimi i shtyrë	(23,716)	-
Totali për shpenzimin e tatim fitimit	-	-

Deklarimet tatimore përgatiten në baza vjetore por fitimet dhe humbjet të deklaruar për qëllime fiskale nuk mund të konsiderohen të finalizuar deri kur organet tatimore kontrollojnë deklaratat dhe dokumentacionin e tatimpaguesit dhe lëshojnë një vlerësim final. Ligjet dhe rregulloret fiskale janë subjekt i interpretimeve të ndryshme nga organet tatimore.

Shoqëria ka njohur tatim të shtyrë aktiv në lidhje me diferencat e përkohshme mes vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve dhe bazës së tatueshme koresponduese përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm. Tatim fitimi i shtyrë lidhjet me humbjet e tatimore të periudhës raportuese, balance e cila do të sjell një ulje në detyrimin për tatim fitimin të periudhave të ardhshme duke sjell një diferencë të përkohshme si aktiv tatimor i shtyrë.

Aktivet tatimore të shtyra kanë të bëjnë me nivelet e ndryshme të amortizimit të aplikuara për qëllime të kontabilitetit dhe fiskale. Shkalla e zbatueshme e taksave për qëllimin e llogaritjes së taksës së shtyrë është 15%. Lëvizja në taksën e shtyrë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019	Fitimi/(humbja) i/e njohur
Aktivi tatimor i shtyrë			
Humbjet e mbartura	89.805	125.791	(35.986)
Diferenca në amortizim	105.021	92.751	12.270
Totali	194.826	218.542	(23.716)

Drejtimi, bazuar në legjislacionin në fuqi beson se llogaritja e tatimit mbi të ardhurat është e përshtatshme për të gjitha vitet tatimore bazuar në vlerësimin e tij mbi shumë faktor, duke përfshirë interpretimet e ligjit tatimor dhe përvojën e mëparshme dhe se çdo kontroll tatimor i ardhshëm nuk do të ketë një efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar të Shoqërisë, rezultatet e operacioneve, ose flukset e mjeteve monetare. Megjithatë, për shkak të natyrës së ligjit të tatimit mbi të ardhurat,

praktikave dhe udhëzimeve lidhur me të, nuk është e mundur të shprehemi me siguri që pozicioni aktual i ligjit të taksave do të mbetet i pakontestueshëm nga autoritetet tatimore.

Albchrome sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

11. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

<i>Kosto</i>	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Automjete	Mobilje dhe Pajisje Elektronike	Aktive në proces	Totali
Më 1 Janar 2019	400	509.051	5.692.855	404.046	102.169	1.090.024	7.798.545
Shtesa	-	82.114	206.641	33.641	8.068	72.213	402.677
Pakësime	-	-	(3.593)	(5.246)	-	-	(8.839)
Transferime	-	588.213	103.004	-	-	(691.217)	-
Më 31 Dhjetor 2019	400	1.179.379	5.998.907	432.441	110.237	471.019	8.192.383
Shtesa	-	4.121	135.287	-	6.863	100.666	246.937
Pakësime	-	-	(3.701)	(3.701)	-	(905)	(4.606)
Transferime	-	135.897	193.700	253	723	(382.655)	(52.082)
Më 31 Dhjetor 2020	400	1.319.397	6.327.894	428.993	117.823	188.125	8.382.632
Amortizimi							
Më 1 Janar 2019	-	159.085	3.539.160	171.846	82.586	-	3.952.677
Amortizimi i vitit	-	32.474	304.444	58.482	9.672	-	405.072
Pakësime	-	-	(2.694)	(5.246)	-	-	(7.940)
Më 31 Dhjetor 2019	-	191.559	3.840.910	225.082	92.258	-	4.349.809
Amortizimi i vitit	-	58.996	304.147	61.769	9.188	-	434.100
Pakësime	-	-	-	(3.701)	-	-	(3.701)
Më 31 Dhjetor 2020	-	250.555	4.145.057	283.149	101.446	-	4.780.207
Vlera kontabël neto							
Më 31 Dhjetor 2019	400	987.820	2.157.997	207.359	17.979	471.019	3.842.574
Më 31 Dhjetor 2020	400	1.068.842	2.182.837	145.843	16.377	188.125	3.602.425

Albchrome sh.p.k.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***12. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)**

Shoqëria ka aktive të vendosura si kolateral më 31 dhjetor 2020 për të siguruar huamarrjet e Shoqërisë. Drejtimi ka vlerësuar në datën e raportimit, duke u bazuar në planet e zhvillimit, që nuk ka tregues të rënies në vlerë, dhe flukset monetare të ardhshme do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar vlerën kontabël të aktiveve të Shoqërisë.

Sikurse është shpjeguar në shënimet 1 dhe 14, Shoqëria si pjesë e koncesionit BOT, ka marrë në përdorim disa aktive afatgjata materiale nga qeveria.

13. AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE

Aktivet afatgjata jo-materiale në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave janë analizuar si më poshtë:

	Tarifa e koncesionit Elbasan	Tarifa e koncesionit Bulqize	Të tjera	Totali
Kosto				
Më 1 Janar 2019	168.000	248.000	13.782	429.782
Shtesa	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2019	168.000	248.000	13.782	429.782
Shtesa	-	-	9.220	9.220
Më 31 Dhjetor 2020	168.000	248.000	23.002	439.002
Amortizim				
Më 1 Janar 2019	99.041	137.514	1.483	238.038
Amortizimi për vitin	3.134	5.022	656	8.812
Më 31 Dhjetor 2019	102.175	142.536	2.139	246.850
Amortizimi për vitin	3.134	5.022	656	8.812
Më 31 Dhjetor 2020	105.309	147.558	2.795	255.661
Vlera kontabël neto				
Më 31 Dhjetor 2019	65.825	105.464	11.643	182.932
Më 31 Dhjetor 2020	62.619	100.442	20.207	183.341

Albchrome sh.p.k.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***13. AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE (VAZHDIM)**

Shoqëria më 1 qershor 2000 mori një koncesion të tipit BOT (Ndërto-Opero-Transfero) për objektet e mëposhtme për 30 vjet: një fabrikë Ferro-kromi në Elbasan dhe dy miniera kromi në Përrenjas dhe Pojsk, për shumën prej Lekë 168.000 mijë. Në datë 25.07.2016, ligji Nr 79/2016, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi shtyerjen e periudhës së koncesionit deri më 31 Dhjetor 2040.

Shoqëria më 22 qershor 2001 mori një koncesion të tipit BOT (Ndërto-Opero-Transfero) për objektet e mëposhtme për 30 vjet: Një minierë Ferro-kromi në Bulqizë, një fabrikë mineralesh në Bulqizë, një fabrikë për përzgjedhen e mineraleve në Klos dhe një fabrikë ferro-kromi në Burrel për një shumë prej Lekë 248.000 mijë.

Në datën 25 korrik 2016, ligji nr 79/2016, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi shtyerjen e periudhës së koncesionit deri më 31 dhjetor 2040.

Aktivet afatgjata jo-materiale të tjera përbëhen kryesisht nga programe kompjuterike dhe licenca, të cilat amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme.

14. AKTIVET MINERARE TË SHTYRA

Kostot e kapitalizuara të aktiveve minerare të shtyra minerare lidhen me zhvillimin e pasurive minerare. Kostot e shtyra të gërmimit janë të lidhura me nivelet specifike të minierës. Kjo përfaqëson kostot e shkaktuara nga Shoqëria për të hapur rrugën në mënyrë që të ketë akses tek minerali. Gjatë vitit 2019 ka përfunduar investimi në projektin e thellësisë së PUS-it 9 dhe ka filluar shfrytëzimi i rezervave minerare në nivelet e thellësisë, njëkohësisht dhe amortizimi i këtij investimi.

	Kosto gërmimi të shtyra	Investimi i ri i paamortizuar akoma	Totali
Kosto			
Më 1 Janar 2019	1.112.122	2.480.000	3.592.122
Shtesa	425.822	-	425.822
Interes i kapitalizuar	2.480.000	(2.480.000)	-
Transferime	32.327	-	32.327
Më 31 Dhjetor 2019	4.050.271	-	4.050.271
Shtesa	250.843	-	250.843
Transferime	71.993	-	71.993
Interes i kapitalizuar	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2020	4.373.107	-	4.373.107
Amortizimi			
Më 1 Janar 2019	816.522	-	816.522
Amortizimi për vitin	113.465	-	113.465
Më 31 Dhjetor 2019	929.987	-	929.987
Amortizimi për vitin	173.174	-	173.174
Më 31 Dhjetor 2020	1.103.161	-	1.103.161
Vlera kontabël neto			
Më 31 Dhjetor 2019	3.120.284	-	3.120.284
Më 31 Dhjetor 2020	3.269.946	-	3.269.946

Albchrome sh.p.k.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***15. QIRATË**

Qiratë në pasqyrën e pozicionit financiar përfaqësojnë qiratë operationale të shoqërisë si qiramarrëse, ku është njohur e drejta e përdorimit të aktivit dhe detyrimi i qirasë për gjithë jetëgjatësinë e saj.

Aktivi me të drejtë përdorimi	Ndërtesa	Automjete	Totali
Më 1 janar 2019	19.558	68.903	88.461
Shtesat	-	-	-
Amortizimi	(9.388)	(14.926)	(24.314)
Më 31 dhjetor 2019	10.170	53.977	64.147
Shtesat	51.105	-	51.104
Amortizimi	(9.168)	(14.830)	(23.998)
Më 31 dhjetor 2020	52.107	39.147	91.253

Detyrimi i qirasë	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Më 1 Janar	63.587	-
Shtesat	51.105	88.461
Interesi i përlogaritur	1.689	2.349
Pagesat e principalit	(25.308)	(26.311)
Efekt nga kursi këmbimit	1.118	(912)
Të ardhura të tjera	(1.026)	-
Më 31 dhjetor	91.165	63.587
Detyrimi i qirasë afatshkurtër	27.360	26.013
Detyrimi i qirasë afatgjatë	63.804	37.574
Totali	91.164	63.587

16. INVENTARI

Inventarët në pasqyrën e pozicionit financiar janë vlerësuar me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme dhe analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Mallra të gatshëm	1.102.040	1.046.512
Lëndët e para	348.727	412.494
Inventarë të tjerë	590.885	583.456
Mallra gjysëm të gatshëm	6.432	6.432
Inventari bruto	2.048.084	2.048.894
Provigjone	(103.914)	(85.738)
Totali	1.944.170	1.963.156

Gjatë vitit 2020 provigjonet e krijuara janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Mallra gjysëm të gatshëm	4.604	4.604
Lëndët e para	26.541	26.541
Materiale të tjera	72.769	54.593
Totali	103.914	85.738

Albchrome sh.p.k.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***16. INVENTARI (VAZHDIM)**

Lëvizjet në vlerën neto të realizueshme janë si më poshte:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Provigjone		
Më 1 janar	(85.738)	(59.273)
Rritje e provigjonit	(18.176)	(26.465)
Më 31 dhjetor	103.914	(85.738)

Më 31 Dhjetor 2020, Shoqëria ka inventare të vendosur si kolateral në lidhje me financimet e marra pranë bankave Raiffeisen, Societe General Albania dhe Intesa SanPaolo. Inventari i vendosur si kolateral përbëhet nga FeCr kokërr, FeCr HC, mineral koncentrat kromi, mineral kromi pluhur etj. përkatësisht Raiffeisen Bank Lekë 405.690 mijë dhe Societe General Albania Lekë 323.733 mijë. Gjithashtu në lidhje me overdraftin nga Banka Societe General Albania, kolaterali i vendosur është mbi inventarin e Shoqërisë duke mbuluar 200% të ekspozimit të kredisë. Ndërkohë Shoqëria ka vendosur barrë siguruese mbi inventarin në vlerën Lekë 1,785,629 mijë, për linjën e re të overdraftit me Intesa San Paolo Bank, disbursuar më 23 janar 2019.

17. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE

Llogaritë e arkëtueshme në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshte:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Llogari të arkëtueshme nga eksportet	853.189	256.676
Llogari të arkëtueshme nga klientë vendas	44.993	44.995
Provigjone të drejta të arkëtueshme	(19.794)	(4.947)
Totali	878.388	296.724

Llogaritë e arkëtueshme nuk mbartin interes dhe në përgjithësi janë të pagueshme brenda harkut kohor nga 30 ditë deri 90 ditë. Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria ka njohur një provigjon për të drejtat e arkëtueshme në vlerën prej 14.847 mijë Lekë.

Më poshtë paraqitet informacioni në lidhje me ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë në llogaritë e arkëtueshme tregtare të Shoqërisë duke përdorur një matricë provizioni:

31 dhjetor 2020	Llogaritë e arkëtueshme tregtare				Totali
	<30 ditë	30-60 ditë	61-90 ditë	>91 ditë	
	Lekë 000	Lekë 000	Lekë 000	Lekë 000	
Norma humbjes së pritshme të kredisë	0.66%	0.81%	6.40%	77.40%	
Vlera bruto pa provigjion	578.530	223.807	13.213	17.222	832.772
Humbja e pritshme e kredisë	3.802	1.815	846	13.331	19.794

Albchrome sh.p.k.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***18. TË TJERA LLOGARI TË ARKËTUESHME DHE PARAPAGIME**

Llogaritë e tjera të arkëtueshme në pasqyrën e pozicionit financiar janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
TVSH e kreditueshme	275.219	559.908
Parapagime për tatim fitimin	168.207	168.207
Shpenzime të periudhave të ardhshme	143.302	20.550
Garanci për çështje me taksat, neto	66.092	66.092
Parapagime të dhëna	77.038	93.535
Rentë minerare të arkëtueshme	17.316	17.316
Parapagime për stafin	54	275
Totali	747.228	925.883

Ligji i ri i TVSH-së në Shqipëri kërkon që Shoqëritë të rimburohen brenda 30 ditëve nga deklarimi i TVSH-së së tyre të arkëtueshme dhe si rezultat TVSH-ja konsiderohet plotësisht e rikuperueshme në kohën e duhur. Shuma e rimbursueshme e TVSH-së është arkëtuar plotësisht gjatë muajit janar dhe shkurt 2021. Shoqëria po ndjek rimbursimin e këtyre të arkëtueshmeve në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Në bazë të shpjegimit në shënimin 28 Shoqëria ka krijuar një provigjion lidhur me garancitë e bllokuara përse i përket çështjeve me autoritetet tatimore referuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Garanci për çështjet me taksat, bruto	208.152	208.152
Provigjone për humbje	(142.060)	(142.060)
Garanci për çështjet me taksat, neto	66.092	66.092

19. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE TË TYRE

Mjete monetare dhe të ngjashme në pasqyrat e pozicionit financiar janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Mjete monetare në bankë	8.676	48.793
Mjete monetare në arkë	887	1.007
Totali	9.563	49.800

20. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar në pasqyrën e pozicionit financiar është analizuar si më poshtë:

	Numri i Aksioneve	% e pjesëmarrjes	Vlera Nominale Lekë' 000
Albchrome Holding shpk	68.470	100%	3.765.963
	68.470	100%	3.765.963

Gjatë vitit 2020 shoqëria nuk ka pasur lëvizje në kapitalin e aksionar.

Albchrome sh.p.k.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***21. HUAMARRJET**

Shoqëria ka marrë hua financiare nga institucionet financiare si vijon:

	Norma e interesit %	Maturiteti	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Huamarrjet				
Kredi bankare	4.0%	10/27/2021	185.546	228.454
Kredi bankare	5.0%	06/30/2022	571.797	672.615
Kredi bankare	4.6%	06/30/2022	573.136	670.482
Kredi bankare	0%		185.145	-
Kredi bankare	0%		7.937	-
Kredi bankare nga palët e lidhura	4.0%	31/3/2021	283.978	166.239
Overdraft bankar	3.5-3.8%	1 vit	1.245.974	1.305.042
Interesa të përlogaritur			1.452	1.358
			3.054.963	3.044.190

Vlera kontabël e huamarrjeve është e përafërt me vlerën e tyre të drejtë meqënëse të gjitha huamarrjet janë marrë me kushte tregu. Overdraftet e marra nga Shoqëria janë të mbuluara për vlerën e tyre të shfrytëzuar me vlerë propocionale në inventarë të kompanisë. Përsa i përket sigurimit të huave që Shoqëria detyrohet ato janë të mbuluara me vlerën e aksioneve të kompanisë.

22. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme janë detyrime që nuk mbartin interes me furnitorët vendas dhe të huaj dhe që normalisht shlyhen brenda një periudhe 30 deri në 180 ditë.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve vendas	368.178	393.348
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve të huaj	263.456	112.980
Detyrime të përlogaritura ndaj furnitorëve	716	2.589
Totali	632.350	508.917

23. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera në pasqyrën e pozicionit financiar janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrimet ndaj METE	203.533	204.229
Të ardhura të shtyra	182.266	34.649
Shpenzime të përlogaritura për paga	64.828	68.818
Detyrime të tjera për taksa	44.306	23.308
Kontributet për sigurimeve shoqërore dhe taksat	40.638	31.633
Parapagime të marra	8.799	2.197
Detyrimet e koncesionit	-	2.309
Dividentë për tu paguar	-	678
Totali	544.370	367.821

Detyrimet ndaj Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës ("METE"), përfshijnë një shumë prej Lekë 203.533 mijë (2019: Lekë 204.229 mijë) e lidhur me penalitetet e vendosura nga Ministria me 2009 por që nuk janë shlyer ende nga Shoqëria. Detyrimi është ende në diskutim ndërmjet shoqërisë dhe Ministrisë.

24. DETYRIME PËR PËRFITIMET E PUNONJËSVE

Detyrime për përfitimet e punonjësve në pasqyrën e pozicionit financiar paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrime për përfitimet e punonjësve	34.844	-
Totali	34.844	-

Bazuar në Marrëveshjen Kolektive të Punës, Shoqëria ka njohur detyrime për përfitimet e punonjësve, që kanë të drejta sipas planit të pensionit të Shoqërisë, të cilat janë përcaktuar në planin e përfitimit nga fondi i pensioneve.

Albchrome sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***25. PROVIZIONE**

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Më 1 janar provizione për çështje ligjore	68.168	68.168
Provizione për rehabilitimin e mjedisit	9.220	-
Provizione të tjera	1.082	-
Totali	78.470	68.168

Provizione të tjera lidhen me auditime tatimore të mëparshme si dhe çështje të ndryshme ligjore nën gjykim si paditës dhe palë e paditur nga palë të treta. Gjatë vitit 2020, nuk ka çështje të reja ligjore.

26. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA

Tabelat e mëposhtme tregojnë shumën totale të transakcioneve që janë kryer me palët e lidhura në vitin e caktuar financiar.

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura pjesë e Grupit Balfin. Një numër transakcionesh janë kryer me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transakcione janë kryer në terma tregtarë dhe në normat e tregut. Transaksionet me palët e lidhura përbëhen nga transakcionet me BFI Trade shpk për blerjen e mineralit të kromit, me Albania Energy Supply shpk për blerjen e energjisë elektrike, me Balfin shpk, MANE TCI dhe Albchrome Holding shpk për shërbime të ndryshme konsulence dhe transakcione me shoqëri të tjera të grupit si NEPTUN shpk, Stella Mare, Milsped Albania, Spar shpk etj. Shoqëria ka huamarrje me shoqërinë mëmë përfundimtare Balfin shpk, dhe ka pasur huamarrje me Tirana Bank sh.a., e cila është bërë pjesë e Grupit Balfin që nga 01 mars 2019.

a) Llogari të arkëtueshme nga/të pagueshme për palët e lidhura

Tepricat e arkëtueshme/ pagueshme që rrjedhin nga transakcionet e përmendura më sipër janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Detyrime nga/ndaj shoqëria/së mëmë përfundimtare	Nga shoqëritë e grupit	Detyrime nga/ndaj shoqëria/së mëmë përfundimtare	Nga shoqëritë e grupit
Mjete monerate në bankë	-	-	-	2.148
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	-	3.304	-	317
Huamarrje me afat	283.978	185.546	166.239	228.454
Të pagueshme nga palët e lidhura	20.036	285.988	1.122	405.656
Interesa të Pagueshëm	-	6.432	-	1.557
Dividend i pagueshëm	-	-	-	678
Totali	304.014	481.270	167.361	638.810

b) Shitje e mallrave dhe shërbimeve/të ardhura

Shitja e mallrave dhe shërbimeve me palët e lidhura janë analizuar si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shitje:		
<i>Shoqëria mëmë:</i>		
Të ardhura nga qiradhënie	193	196
<i>Shoqëri të lidhura:</i>		
Të ardhura nga shitja lëndëve të para	1.689	2.451
Të ardhura nga qiradhënie	793	826
Të ardhura të tjera	2.456	737
Totali	5.131	4.210

26. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

c) Blerje e mallrave dhe shërbimeve/shpenzime

Blerjet e mallrave dhe shërbimeve nga palët e lidhura analizohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Blerje:		
<i>Shoqëria mëmë:</i>		
Blerje e shërbimeve	29.460	37.511
Shpenzime interesi	13.992	1.621
<i>Shoqëri të lidhura:</i>		
Blerje e lëndëve të para (koncentrat kromi)	65.685	1.296.578
Blerje e energjisë elektrike	1.244.544	1.989.638
Blerje e shërbimeve	18.868	16.626
Shpenzime transporti, porti etj.		45.388
Blerje e materialeve	5.374	8.946
Shpenzime të tjera financiare	6.545	4.794
Shpenzime interesi	7.141	2.707
Shpenzime qiraje		3.782
Shpenzime të tjera		3.042
Totali	1.391.609	3.410.633

27. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT

Instrumentat kryesorë financiarë të Shoqërisë përbëhen nga kredi bankare dhe hua afatshkurtra, para dhe depozita afatshkurtra. Qëllimi kryesor i këtyre instrumentave financiare është të sigurojë financim për aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria ka edhe disa aktive dhe detyrime financiare të tjera si për shembull llogari të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme, që rrjedhin direkt nga aktivitetet e saj. Administrimi i rrezikut kryhet sipas politikave të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.

Rreziqet kryesorë që rrjedhin nga instrumentet financiare të shoqërisë janë risqet e likuiditetit, risqet e kurseve të këmbimit dhe risku i kreditit. Drejtimi rishikon dhe aprovon politikat për administrimin e secilit prej këtyre rreziqeve të cilat janë përmbledhur më poshtë.

a) Rreziku i normave të interesit

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut për ndryshime në normat e interesit të tregut lidhet kryesisht me huamarrjet afatgjata të shoqërisë që janë me normë interesi të ndryshueshme. Më 31 Dhjetor 2020 Shoqëria ka borxh me normë interesi të ndryshueshme nga bankat.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Norma fikse e interesit		
Detyrime financiare	283.978	166.239
Norma variable e interesit		
Detyrime financiare	2.770.985	2.877.951

Një ndryshim prej 100 deri 300 pikë bazë në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të kishte ndikim të rëndësishëm në rezultatin financiar të Shoqërisë.

27. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT (VAZHDIM)

Të ardhurat dhe flukset monetare operative të Shoqërisë janë në mënyrë të konsiderueshme të pavarura nga ndryshimet e normave të interesit të tregut, gjithsesi efekti që një ndryshim në normat e interesit do të kishte në rezultatet e Shoqërisë është rritur për shkak të rritjes në huatë afatshkurtra deri afatmesme, në monedhën Lekë, që do të ndikonte në uljen e fitimit para tatimit, si vijon:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Rritje prej 100 Pikë Bazë	(27.710)	(28.780)
Në % të fitimit para tatimit	(95.68%)	(3.66%)
Rritje prej 300 Pikë Bazë	(83.130)	(86.339)
Në % të fitimit para tatimit	(287.03%)	(10.98%)

b) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria hyn në transaksione në valutë të huaj në lidhje me shitjet e produkteve të saj dhe blerjen e aktiveve fikse dhe blerjet e mallrave tregtare nga palët e lidhura. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument të veçantë financiar mbrojtës kundër këtyre risqeve, dhe nuk ka instrumente të tilla në përdorim të gjerë në Republikën e Shqipërisë. Prandaj, Shoqëria është e ekspozuar potencialisht ndaj risqeve të tregut që lidhen me luhatjet e mundshme të kurseve të këmbimit të valutave të huaja.

31 dhjetor 2020	Totali	EURO	USD	ALL
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	1.625.616	78.530	889.758	657.329
Mjete monetare në bankë dhe arkë	9.563	1.594	4.047	3.921
Llogari të pagueshme dhe të tjera	(1.290.035)	(353.335)	(389.239)	(600.194)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(306.024)	(267.804)	(1.502)	(36.718)
Huamarrje me interes	(283.978)	(119.818)	(141.176)	(22.984)
Interest-bearing borrowing	(1.728.381)	(206.936)	(1.392.425)	(129.021)
Ekspozimi neto	(1.973.239)	(867.769)	(1.030.536)	(127.667)

31 dhjetor 2019	Totali	EURO	USD	ALL
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	1.222.607	68.945	312.052	841.610
Mjete monetare në bankë dhe arkë	49.800	44.000	1.481	4.319
Llogari të pagueshme dhe të tjera	(944.906)	(305.808)	(102.497)	(536.600)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(407.447)	(250.210)	(144.655)	(12.582)
Huamarrje me interes	(166.239)	(85.240)	-	(81.000)
Interest-bearing borrowing	(1.555.439)	(206.451)	(1.348.988)	-
Ekspozimi neto	(1.801.624)	(734.764)	(1.282.607)	215.747

Albchrome sh.p.k.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***27. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT (VAZHDIM)****b) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)**

Kurset e këmbimit të aplikuara gjatë vitit:

	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2020	2019	2020	2019
1 EUR / LEK	123.77	123,01	123.7	121,77
1 USD / LEK	108.52	109,85	100.84	108,64

c) Rreziku i likuiditetit

Politikat e kujdesshme të administrimit të rrezikut të likuiditetit nënkupton ruajtjen e mjeteve monetare të mjaftueshme dhe disponueshmërinë e fondeve me anë të një sasive të mjaftueshme linjash krediti. Tabela më poshtë përmbledh profilin e maturimit të detyrimeve financiare të shoqërisë në 31 Dhjetor 2020 dhe 2019, bazuar në pagesat kontraktuale të paskontuara.

Më 31 dhjetor 2020	deri në 3 muaj	3 deri 12 muaj	1 deri 5 muaj	Totali
Huamarrje afatshkurtra	99.856	576.934	1.562.196	2.238.987
Huamarrje afatshkurtra nga palët e lidhura	120.744	163.234		283.978
Llogari të pagueshme dhe të tjera	330.879	1.584.887	-	1.915.766
Detyrime ndaj palëve të lidhura	924.541	-	-	924.541
	1.476.020	2.325.055	1.562.196	5.363.272

Më 31 dhjetor 2019	deri në 3 muaj	3 deri 12 muaj	1 deri 5 muaj	Totali
Huamarrje afatshkurtra	28.906	1.526.533	1.322.512	2.877.951
Huamarrje afatshkurtra nga palët e lidhura	85.319	80.920		166.239
Llogari të pagueshme dhe të tjera	876.738	-	-	876.738
Detyrime ndaj palëve të lidhura	407.447	-	-	407.447
	1.398.410	1.607.453	1.322.512	4.328.375

d) Rreziku i kreditit

Shoqëria nuk ka përqendrim të konsiderueshme të riskut të kredisë. Shoqëria ka aprovuar politika të tilla krediti për të siguruar që shitja e produkteve të bëhet për klientët me një histori krediti të përshtatshme. Shoqëria ka politika që kufizojnë sasinë e ekspozimit të kredisë për çdo klient. Përveç kësaj, për të zvogëluar këtë rrezik Shoqëria ka kërkuar si kolateral garanci bankare dhe depozita bankare. Rreziqet e njohura janë marë parasysh duke krijuar provigjone për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Në lidhje me risqet e kreditit që rrjedhin nga aktivet e tjera financiare të shoqërisë, të cilat përbëhen nga paraja dhe ekuivalentët dhe të tjera të arkëtueshme afatshkurtra të shoqërisë, ekspozimi i shoqërisë ndaj riskut të kreditit lind nga vonesa e palës tjetër, me një ekspozim maksimal të barabartë me vlerën kontabël të këtyre instrumenteve.

e) Rreziku i çmimit të mineralit

Shoqëria shet të gjithë prodhimin në tregun e huaj, si rrjedhojë çmimi i shitjes është i ndikuar nga lëvizshmëria e cmimeve në bursë. Shoqëria nuk është duke përdorur ndonjë instrument mbrojtës ose kompensimi për ndryshimet e cmimeve në bursë.

28. VLERA E DREJTË

Vlera e drejtë e aktiveve afatshkurta dhe pasiveve afatshkurtra me pale treta i përafrohet vlerave të mbartura për afate kohore të shkurtra lidhur me natyrën e tyre afatshkurtër. Vlera e drejtë e huave afatgjata ndryshon nga vlera e mbartur pasi ato kanë normë interesi fikse.

Hierarkia e vlerës së drejtë

Drejtimi është bazuar në gjykim për të konkluduar që vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë i përafrohet vlerës së tyre të mbartur. Si rrjedhojë, gjithë vleresimit në lidhje me vlerën e drejtë kategorizohen në Nivelin 3 sipas SNRF 7.

29. ADMINISTRIMI I KAPITALIT

Objektivi kryesor i administrimit të kapitalit të Shoqërisë është që të sigurohet se ajo ka një vlerësim të fortë përse i përket rrezikut të kreditit dhe raporteve të shëndetshme të kapitalit në mënyrë që të mbështesin biznesin e tyre dhe për të maksimizuar pasurinë e aksionerëve. Shoqëria administron kapitalin dhe strukturën e saj dhe bën korrigjimet e nevojshme, në varësi të ndryshimeve në kushtet ekonomike. Për të ruajtur apo për të rregulluar strukturën e kapitalit, Shoqëria mund të rregullojë pagesën e dividendëve për aksionerët, të kthejë kapital të aksionerët apo të emëtojë aksione të reja.

Nuk ka pasur ndryshime në qëllimet, politikat ose proceset gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2020.

Shoqëria monitoron kapitalin duke përdorur si matës raportin e borxhit, i cili është borxhi neto i pjesëtuar me totalin e kapitalit duke i shtuar borxhin neto. Politika e Shoqërisë është që të mbajë këtë raport borxhi në nivele të pranueshme duke marrë parasysh nivelin ekonomik. Shoqëria përfshin në borxhin neto, huamarrje me interes dhe kreditë e marra nga palët e treta duke përjashtuar shoqërinë mëmë, llogaritë e pagueshme minus aktivet likuide. Kapitali vetë përfshin kapitalin që i atribuohet aksionerëve të Shoqërisë mëmë dhe kreditë e marra nga Shoqëria mëmë.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kredi dhe huamarrje me interes	2.770.985	2.877.951
Llogari të pagueshme	632.350	508.917
Minus: Mjete monetare dhe depozitat afatshkurtra	(9.563)	(49.800)
Borxhi Neto	3.393.772	3.337.068
Kapitali	6.178.909	6.203.912
Huamarrje nga shoqëria mëmë	283.978	166.239
Totali i Kapitalit	6.462.887	6.370.151
Kapitali dhe Borxhi Neto	9.856.659	9.707.219
Raporti i Borxhit	34.43%	34.38%

Albchrome sh.p.k.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***30. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA***Angazhime*

Sipas kontratave, pagesat e ardhshme janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Brenda vitit		
Qira (Zyra & Automjete)	27.360	-
Investimet në pusin 9	-	384.647
	27.360	384.647
Pas 1 por jo më shumë se 5 vjet		
Qira (Zyra & Automjete)	63.804	-
Investimet në pusin 9	-	664.343
	63.804	664.343
Totali	91.164	1.048.990

Në fund të vitit 2019 Shoqëria kishte një projekt investimi që do të kryhej në pusin 9 për të hapur nivelet e thellësisë, gjatë vitit 2020 Shoqëria vendosi që këto investime të kryheshin nga punonjësit e Albchrome.

Çështje ligjore

Shoqëria gjatë rrjedhës së rregullt të veprimtarisë së saj ka qenë e përfshirë në çështje të ndryshme ligjore në gjykim si paditës dhe si e pandehur nga palë të treta dhe punonjës të shkarkuar. Shoqëria ka një pritje pozitive për të gjitha rastet e mësipërme.

Gjatë vitit 2020, Shoqëria fitoi çështjen gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me Autoritetin Tatimor për të ardhurat me interes të rimbursimit të vonuar të TVSH-së për shumën 68 milion lekë, vendimin nr. 1415 datë 08.07.2020. Autoriteti i Taksave ka bërë një apel për të revokuar vendimin e mësipërm në Gjykatën Administrative të Apelit.

31. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje tjetër të rëndësishme pas datës së publikimit të pasqyrave financiare, që kërkon rregullime ose informacione shpjeguese në pasqyrat financiare.